

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6929
E premte, 23 qershor 2023
Çmimi 0.40

Rexhep Qosja, krijuesi i madh në universin kombëtar shqiptar | FAQE 8

Prof. dr. Kudusi LAMA, gjeneral në pension



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PDK-ja DHE LDK-JA KANË REFUZUAR NJË TAKIM ME PRESIDENTEN VJOSA OSMANI PËR TË DISKUTUAR PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË VEND | FAQE 4-5

OSMANIT I KËRKOHEM CAKTIMI I DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE




Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i kanë kthyer përgjigje negative presidentes Vjosa Osmani, e cila, me kërkesë të liderit të AAK-së, Ramush

Haradinaj, u ka dërguar ftesë partive politike për një takim rreth ngjarjeve të fundit në vend. Krasniqi, i cili e ka publikuar përgjigjen që ia ka kthyer Osmanit, ka thënë se është i gatshëm

të takohet me të parën e shtetit në çfarëdo kohe për të diskutuar për caktimin e datës së mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë

AKTUALE




BORRELLI: SITUATA NË VERI VAZHDON TË JETË SHUMË E TENSIONUAR F. 3

NDËRRON JETË DORËSHKRUESI I DEKLARATËS SË PAVARËSISË, SHYQRI NIMANI F. 7

SALI BISLIMI NË STRASBURG KËRKON THEMELIMIN E NJË GJYKATE SPECIALE PËR SERBINË PËR KRIMET NË KOSOVË F. 8

EKONOMI



KËRKOHEM RISHIKIMI I BUXHETIT DHE RITJJA E PAGAVE NË SEKTORIN PUBLIK F. 8

SË SHPEJTI FILLOJNË SHPRONËSIMET NË RRUGËN DRAGASH - BROD F. 8

SPORT



FANELLA E KOSOVËS, ËSHTË FANELLË... E GJAKUT F. 10

STOLTENBERGU: SITUATA NË KOSOVË DËSHMON SE PRANIA E NATO-S ËSHTË E RËNDËSISHME | FAQE 5



KURTI TAKON PAPA FRANÇESKUN NË SELINË E SHENJTË | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Scholz: NATO-ja të përqendrohet në forcimin e fuqisë luftuese të Ukrainës

BERLIN, 22 QERSHOR - Kancelari gjerman Olaf Scholz u bëri thirrje liderëve të NATO-s që gjatë takimit të tyre në Vilnius në korrik, të përqendrohen në rritjen e kapacitetit luftarak të Ukrainës gjatë kundërofensivës së Kievit ndaj forcave ruse.

Një çështje kyçe që duhet ngritur gjatë takimit të 11 dhe 12 korrikut do të jetë e ardhmja e raporteve mes Ukrainës dhe NATO-s, tha Scholz. "Ne duhet ta shohim qartë situatën aktuale", tha Scholz para ligjvënësve në Berlin, duke shtuar se Kievit "vetë ka thënë se anëtarësimi në NATO nuk është kërkesë përderisa Rusia vazhdon luftën e saj kundër Ukrainës". "Prandaj unë po kërkoj që ne të fokusohemi në atë çfarë është tani prioriteti kryesor e që është forcimi i fuqisë luftuese të Ukrainës".

Përveç kësaj, Scholz tha se Gjermania do të punojë me G7 dhe partnerët e Bashkimit Evropian, por edhe me Kievin, për të arritur "te zotimet efektive dhe afatgjata të sigurisë".

Këto do të sigurojnë që Ukraina të marrë mbështetje të qëndrueshme ushtarake, por edhe fuqinë e nevojshme ekonomike për ta mbrojtur veten nga agresioni rus, tha kancelari gjerman.

Samiti në Vilnius, tha ai, do të dërgojë "një sinjal të fortë" për bashkëpunimin dhe vendosmërinë transatlantike.

Gjermania, përveç ndihmës ushtarake që i ka dhënë Ukrainës, ka rritur shpenzimet për ushtrinë e saj për shkak se i duhet t'i zëvendësojë armët në stoqet e saj, pas donacioneve që i ka dhënë Kievit.



Ukraina goditet nga një valë e re e sulmeve ruse



KIEV, 22 QERSHOR - Forcat ruse kanë goditur caqe civile dhe të infrastrukturës përmes një vale të raketave dhe dronëve të lëshuara gjatë natës, tha ushtria ukrainase mëngjesin e 22 qershorit.

Ushtria shtoi se beteja të ashpra po zhvillohen në rajonin lindor ukrainas të Donjeckut, ku Rusia ka shtuar sulmet.

Në Krimenë e aneksuar nga Rusia, një urë kyçe që e lidh këtë gadishull me pjesët e pushtuara të Ukrainës në rajonin jugor të Hersonit, u dëmtua pasi u godit, sipas zyrtarëve të instaluar nga Moska, me raketa Storm

Shadow, të lëshuara nga forcat ukrainase.

Shtabi i Përgjithshëm raportoi se mbrojtja ajrore ukrainase ka rrëzuar të gjashtë dronët e prodhimit iranianë, por shtoi se një numër i paspecifikuar i civilëve janë vrarë dhe plagosur, pa dhënë më shumë detaje.

Rusia ka lëshuar 44 raketa dhe 47 predha drejt infrastrukturës civile ukrainase, tha ushtria.

Kreu i administratës rajonale ushtarake në Odesa, Sehiy Bratchuk, tha se tre dronë u rrëzuan në jug të Ukrainës, por dronët e tjerë kanë shkaktuar dëme të vogla në rajonin e

Odesës.

Pavlo Kyrlyenko, kreu i rajonit të Donjeckut, tha se një civil është vrarë nga granatimet ruse dhe gjashtë të tjerë janë plagosur në Çasiv Jar, afër Horlivkës.

Autoritetet në rajonet Krivi Rih, Dnipropetrovsk, Herson dhe Harkiv, po ashtu, kanë raportuar për granatime gjatë natës. Në Harkiv një person është plagosur, thanë autoritetet. Që nga muaji i kaluar Rusia ka shtuar sulmet ajrore në mbarë Ukrainën, duke shkaktuar shumë viktima civile dhe duke shkaktuar dëme të mëtejme në infrastrukturën e Ukrainës.

Shtohen kërkimet për nëndetësen e zhdukur

Nju-Jork, 22 qershor - Një ekip shumëkombësh për kërkim-shpëtim po vazhdon kërkimet nga deti dhe ajri për nëndetësen e zhdukur, Titan.

Nëndetësja me pesë turistë në bord u nis të dielën drejt rrënojave të Titanikut, por humbi kontaktin një orë e 45 minuta pas nisjes. Ekipet e shpëtimit janë në garë me kohën pasi nëndetësja besohet se i kanë mbetur vetëm disa orë furnizime me oksigjen.

Nëndetësja Titan, që operohet nga kompania me seli në Shtetet e Bashkuara, OceanGate, ishte nisur drejt anijes së fundosur Titanik të dielën në orën 08:00 sipas kohës lokale. Nëndetësja humbi kontaktin me anijen mbështetëse më pak se dy orë pas nisjes drejt Titanikut në Oqeanin Atlantik.


Titan nisi ekspeditën me 96 orë furnizime me oksigjen, tha kompania OceanGate, që

nënkupton se furnizimet mund të harxhohen mëngjesin e së enjtes. Por, ekspertët thanë se sa gjatë mund të zgjasin furnizimet me oksigjen varet nga disa faktorë, sikurse nëse nëndetësja ende ka energji elektrike dhe sa të qetë qëndrojnë pasagjerët në bordin e saj.

Të mërkurën Rojet Bregdetare amerikane thanë se avionët kanadezë kanë dëgjuar zhurma nën ujë.

Ekipet e kërkim-shpëtimit kanë lëshuar nën ujë disa pajisje kërkuese në zonën ku janë detektuar zhurmat, por zyrtarët kanë paralajmëruar se zhurmat e detektuara mund të mos kenë ardhur nga nëndetësja Titan.

"Kur jeni në mes të ekipeve të kërkim-shpëtimit, ju gjithmonë keni shpresë", tha kapiteni i Rojeve Bregdetare, Jamie Frederick, gjatë një konferencë për medie të mërkurën. "Sa iu përket zhurrmave, ne nuk e dimë



se çfarë saktësisht janë ato". Frederick shtoi se analizat e të dhënave të marra nga bovat sonare "janë të paqarta".

Pjesët e anijes së fundosur të Titanikut gjenden 3810 metra në thellësi të detit, mbi 640 kilometra në jug të Njufondland

të Kanadasë.

Pasagjerët në Titan kishin paguar nga 250 000 dollarë secili për këtë ekspeditë.

Kurti takon Papa Françeskun në Selinë e Shenjtë

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

VATIKAN, 22 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë vizitës së tij në Vatikan, është pritur të enjten nga Ati i Shenjtë, Shenjtëria e tij, Papa Françesku. Në këtë takim të përzemërt, në mëngjesin e ditës më të gjatë të vitit, siç veçoi kryeministri në takim, ai u shpreh falënderues dhe shumë i lumtur për mikpritjen kaq dashamirëse. Ai tha se Republika e Kosovës është e përcaktuar për paqe, dialog dhe bashkëpunim.

Me Papa Françeskun biseduan për rininë dhe ardhmërinë, për figurën, veprën dhe trashëgiminë e Nënës Terezë, për Letnicën e Vitisë ku asaj i erdhi thirrja për devocion, edhe për bashkëjetesën multifetare në Kosovë.

Kryeministri më tej e njoftoi Atin e Shenjtë edhe për suksesin demokratik dhe ekonomik të vendit, dhe për arritjet e qeverisjes së deritanishme, duke theksuar faktin që jemi qeveria e parë që po jep shtesa për nënat lehona dhe fëmijët deri në moshën 16 vjeç, si politikë mbështetëse për ta.

Për besimin e tij, kryeministri Kurti tha se politika është shërbim, teksa e ftoi



Shenjtërinë e tij, Papa Françeskun, ta vizitojë Kosovën, pas rikuperimit të shpejtë dhe të mirë nga operacioni kirurgjik që kishte së fundmi.

Ata u pajtuan se duhet që përherë të jemi pranë e me popullin i cili ka nevojë për dashuri dhe drejtësi. Kjo ishte vizita e parë zyrtare e kryeministrit Kurti në Vatikan dhe takimi i parë i tij me Atin e Shenjtë, Papa Françeskun.

Kurti u mirëprit edhe nga sekretari i Shtetit i Selisë së Shenjtë, Kardinali Pietro Paroli

Në Vatikan, kryeministri Kurti, i shoqëruar nga përfaqësuesi i Republikës së Kosovës për Selinë e Shenjtë, Vehbi Miftari dhe ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, u takua edhe me sekretarin e Shtetit të Selisë së Shenjtë, Kardinalin Pietro Paroli.

Ai e njoftoi për sukseset e Kosovës dhe progresin në Kosovë, sidomos në dy vitet e fundit, si dhe për orientimin euroatlantik të saj dhe për përkushtimin e palëkundur ndaj vlerave demokratike. Në takim u diskutua për

raportet historike me Vatikanin dhe për historikun e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Vatikanit. Kryeministri theksoi rëndësinë e avancimit të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve dhe rolin pozitiv që njohja nga Vatikani do ta kishte për shtetin, shoqërinë dhe popullin e Kosovës, për rajonin dhe për paqen e qëndrueshme. Kryeministri Kurti dhe sekretari i Shtetit, Kardinali Paroli, folën edhe për procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe për zhvillimet e fundit në kuadër të tij. Kryeministri tha se zgjidhja dhe rruga përpara është zbatimi i plotë, i shpejtë dhe pa kushte i Marrëveshjes Bazike të 27 shkurtit dhe Aneksit të saj të pajtuar më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Ai shtoi se Kosova është dëshmuar në vazhdimësi palë konstruktive për gjatë gjithë procesit dhe gjatë fazave të negociatave të marrëveshjeve. Pas këtij takimi, kryeministri Kurti ka përfunduar qëndrimin e tij në Itali dhe vizitën e tij zyrtare në Vatikan.



Borrelli: Situata në veri vazhdon të jetë shumë e tensionuar

BRUKSEL, 22 QERSHOR - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, para takimit të enjten në Bruksel me kryeministrin Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se situata në veri vazhdon të jetë shumë e tensionuar.

“Situata në veri të Kosovës vazhdon të jetë shumë e tensionuar. Sot ne synojmë të gjejmë zgjidhje për deeskalim të menjëhershëm dhe një rrugë përpara”, ka shkruar Borrelli në “Twitter”. Është paralajmëruar se takimet në Bruksel do të jenë vetëm takime

dypalëshe, mes bartësve të dialogut, Albin Kurti dhe Aleksandër Vuçiq, me ndërmjetësit evropianë të dialogut. Zëdhënësjja e BE-së, Nabila Massrali, në një konferencë për shtyp të enjten, nuk ka treguar saktësisht se a do të ketë apo jo takim trepalësh.





PDK-JA DHE LDK-JA KANË REFUZUAR NJË TAKIM ME PRESIDENTEN VJOSA OSMANI PËR TË DISKUTUAR PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË VEND

Osmanit i kërkohet caktimi i datës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i kanë kthyer përgjigje negative presidentes Vjosa Osmani, e cila, me kërkesë të liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj, u ka dërguar ftesë partive politike për një takim rreth ngjarjeve të fundit në vend. Krasniqi, i cili e ka publikuar përgjigjen që ia ka kthyer Osmanit, ka thënë se është i gatshëm të takohet me të parën e shtetit në çfarëdo kohe për të diskutuar për caktimin e datës së mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka bërë me dije të enjten se ka pranuar nga presidentja Vjosa Osmani një letër me të cilën është ftuar në takim pas një propozimi nga kryetari i AAK-së.

Krasniqi ka treguar se e ka refuzuar këtë ftesë të Osmanit. "Gjatë këtyre ditëve të vështira për Kosovën, me indinjatë kam vërejtur se presidentja ka qendruar e heshtur dhe ka neglizhuar obligimin e saj kushtetues për ta garantuar unitetin qytetar, për t'i ruajtur

marrëdhëniet me partnerët strategjikë ndërkombëtarë dhe për të vepruar si institucion mbi palët. Prandaj, duke u nisur nga këto, por edhe arsye të tjera që i kam shtjelluar në letrën e përgjigjes sime, e kam parë të udhës që ta refuzoj pjesëmarrjen në këtë takim", ka thënë lideri i PDK-së.

Kryetari i AAK-së në letrën drejtuar presidentes ka kërkuar takim mes udhëheqësve të shtetit dhe kryetarëve të partive politike në vend për situatën në vend.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, në letrën drejtuar Osmanit ka thënë se është i gatshëm të takohet me shefen e shtetit për caktimin e datës së

zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. "Po e konfirmoj se jam i gatshëm të takohem me ju, në çfarëdo kohe, për të diskutuar për caktimin e datës së mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë si obligim institucional", ka thënë Krasniqi në letrën drejtuar Osmanit.

Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, e ka refuzuar ftesën e presidentes Osmani për një takim konsultativ në lidhje me zhvillimet e fundit, por ai i ka dërguar edhe një letër.

Në letrën që e ka parë gazeta "Nacionale", Abdixhiku argumenton se as nuk është konsultuar paraprakisht nga

Ramush Haradinaj, kryetari i AAK-së dhe propozuesi i kësaj iniciative në lidhje me takimin në fjalë. "Lidhja Demokratike e Kosovës ka përcjellë me shumë shqetësim zhvillimet e fundit politike në vend, në veçanti qasjen e papërgjegjshme të kryeministrit të Kosovës në raport me aleatët tanë, ShBA-në, BE-në e NATO-n. Qasja e tij konfliktuoze, veprimet e pakoodinuara dhe papërgjegjësia diplomatike e strategjike, kanë rrezikuar sovranitetin e Republikës së Kosovës", shkruhet në këtë letër. Abdixhiku e informon presidenten se shqetësimet e adresuara në Kuvendin e Kosovës "nuk kanë gjetur as mirëkuptimin më të vogël nga ana e Qeverisë së Kosovës." Po ashtu, në letër thuhet se kjo parti s'mund ta pranojë e as tolerojë përplasjen e Kosovës me aleatët e saj. "Për më tepër, LDK-ja nuk mund të jetë pjesë e asnjë diskutimi mbi këtë çështje."

Partia e dytë opozitare ka kërkuar që të ketë pozicionim të qartë kritik kundër (sic) popullizmit të

kryeministrit Albin Kurti. "Në këtë ballafaqim, pozicioni i presidentes është jetim; konform historisë sonë të lavdishme, konform zotimeve kushtetuese të pashkelshme, konform bindjeve të vet popullit të Kosovës", thuhet tutje.

Abdixhiku ka shprehur gatishmërinë që të takohet me presidenten në një rast tjetër, por vetëm artikulohet qartë e publikisht për krahuja e aspiratës euroatlantike të institucioneve të Kosovës dhe "refuzimi i politikave përplasëse e izoluese të Qeverisë së Kosovës".

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, në një deklaratë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës të enjten, duke folur për situatën e krijuar së fundi, ka parashtuar tri pyetje për deputetët dhe kabinetin qeveritar lidhur me atë nëse Kosova ka humbur besimin e aleatëve, kanë filluar ndëshkimet dhe është dobësuar përballë kundërshtarëve.

Haradinaj në seancën e Kuvendit

Stoltenbergu: Situata në Kosovë dëshmon se prania e NATO-s është e rëndësishme

BRUKSEL, 22 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se situata aktuale në Kosovë është dëshmi se në këtë shtet është e rëndësishme prania e misionit paqeruajtës të aleancës, KFOR. Këtë deklaratë ai e ka bërë gjatë një takimi në selinë e NATO-s me presidentin e ri të Malit të Zi, Jakov Millatoviç. "Situata në Kosovë dëshmon se prania e NATO-s është e rëndësishme. Ne do të jemi besnikë ndaj mandatit që kemi sipas rezolutës së OKB-së dhe kemi rritur praninë tonë në Kosovë si

përgjigje ndaj rritjes së sfidave të sigurisë. Prania jonë është për ta siguruar lirinë e lëvizjes dhe mjedisit të sigurt për të gjithë qytetarët në Kosovë. Në këtë drejtim, ne e mbështetim edhe dialogun [midis Kosovës dhe Serbisë] dhe i ftojmë palët të përmbahen nga veprimet e njëanshme të cilat mund ta përshkallëzojnë situatën", ka thënë ai. Me qëllim që ta shtensiojë situatën, BE-ja të enjten ka mbajtur takime në Bruksel me liderët e Kosovës dhe të Serbisë.

Stoltenbergu dhe Millatoviç i kanë ftuar Kosovën dhe Serbinë t'i ulin tensionet mes tyre dhe të përqendrohen në kalimin e kësaj situatë përmes dialogut. Stoltenbergu tha se pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës, NATO ka shtuar praninë e saj dhe përmes misionit të saj paqeruajtës në Kosovë, KFOR angazhohet për të siguruar një mjedis të sigurt për të gjithë. "I ftoj palët t'i ulin tensionet dhe të kthehen në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Kjo është kyçe për

qetësinë në Kosovë dhe për stabilitetin e gjithë rajonit", ka thënë shefi i NATO-s. Ndërkaq, presidenti i Malit të Zi, Jakov Millatoviç, tha se për shtetin e tij stabiliteti i rajonit të Ballkanit Perëndimor ka një rëndësi të veçantë dhe angazhimi i përbashkët i NATO-s dhe BE-së e forcon sigurinë e tërë rajonit. Që nga fundi i majit tensionet në veri të Kosovës u rritën pasi kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri, me asistimin e Policisë së Kosovës, hynë në ndërtesat komunale,

mes kundërshtimeve nga serbët lokalë. Më 29 maj serbët lokalë në Zveçan u përleshën me trupat e KFOR-it. Nga përleshjet u lënduan dhjetëra persona nga të dyja palët. Më 14 qershor tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë u përkeqësuan edhe më tej, pas arrestimit të tre zyrtarëve policorë të Kosovës. Serbia tha se ata u arrestuan "thellë" brenda territorit të saj, por Kosova tha se ata ishin duke patrulluar në territorin e Kosovës, pranë vijës kufitare me Serbinë në Leposaviq.



të Kosovës, po ashtu, ka kritikuar dy partitë opozitare, Partinë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës, se në tërësi këtë situatë nuk po kanë guxim të votojnë për mocionin për rrëzimin e qeverisë Kurti. "...E kemi humbur besimin, kanë filluar ndëshkimet dhe jemi dobësuar përballë të gjithëve. S'ka palë kundërshtare e jona që nuk e shfrytëzon këtë. Në një situatë si

kjo më së paku një takim me dyer të mbyllura të udhëheqësve institucionalë me ata politikë. Pse ka hezitime për mocionin? Pse bre s'po keni guxim të thoni ta votojmë mocionin? Çka po ndodh tek opozita? Ku e keni problemin, kolegë opozitarë, PDK e LDK, që po mendoni hala se kush përfiton prej mocionit? Këtu veç një përfitues është, Kosova dhe interesi ynë...", u shpreh

Haradinaj. Ai para deputetëve shtroi pyetjen nëse është dikush që ende nuk e di se jemi duke e humbur besimin e aleatëve, ose që nuk ka ndodhur humbja e besimit. "Nëse është dikush që mendon se nuk e kemi humbur besimin, kisha pasur dëshirë të bisedoj me të", ka thënë i pari i AAK-së. Sipas tij, deputetët nuk mund të sillen sikur nuk ka ndodhur asgjë. "Unë nuk e kuptoj

më këtë parlament. Ne jemi komikë këtu nëse vijmë edhe sillemi sikur s'ka ndodhur asgjë. Atëherë çka? Jemi duke u sjell me tallje ndaj të gjithë brezave që me mund na kanë sjellë këtu ku jemi...", ka deklaruar Haradinaj. Presidentja Vjosa Osmani në letërën që ia ka drejtuar liderit të PDK-së ka theksuar se bashkëpunimi dhe dialogu i hapur ndërmjet institucioneve dhe partive politike

janë thelbësore për t'i përballuar sfidat aktuale dhe për të punuar së bashku drejt arritjes së synimeve të përbashkëta që, sipas saj, përfshin mbrojtjen e tërësisë territoriale, sovranitetit dhe kushtetutshmërisë, si dhe fuqizimin ndërkombëtar të republikës, sikurse edhe përmeshjen e prioritetit shtetëror - anëtarësimit në NATO dhe BE.

Aksioni për mirëmbajtjen e hapësirave publike në Gjilan ka vazhduar në lumin Morava

GJILAN, 22 QERSHOR - Në Gjilan po vazhdon aksioni për pastrimin e hapësirave publike, përfshirë edhe lumenjtë dhe varrezat. Kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka thënë se mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave publike, përkatësisht një qytet i gjelbër

dhe i qëndrueshëm, është një nga prioritetet e komunës së Gjilanit. “Sot, të gjithë së bashku, institucionet komunale, Qendra Rinore dhe shkolla ‘Vatra e Diturisë’ e fshatit Livoç i Epërm si dhe Skat Consulting punuan për pastrimin e pellgut të lumit Morava”, ka thënë kryetari

Hyseni.

Aksioni ka për qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit ndaj ambientit. “Përveç ruajtjes së lumenjve, aktivitetet e tilla rritin edhe ndërgjegjësimin e komunitetit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ambientit ku jetojmë”, ka deklaruar Hyseni.



Mbahet konsultimi publik me biznese dhe fermerë të Rahovecit për qarkoren e parë buxhetore

RAHOVEC, 22 QERSHOR - Komuna e Rahovecit ka mbajtur konsultim publik me biznese dhe fermerë për qarkoren e parë buxhetore. Ky konsultim ka për qëllim që komuna së bashku me qytetarët të hartojnë dhe vendosin për prioritetet në projekte, politika publike dhe në gjithë vendimmarrjen e komunës. Kërkesat më pas do të hyjnë edhe në projektbuxhetin e vitit 2024. Afrim Limani, drejtor për Buxhet dhe Financa në komunën e Rahovecit, ka bërë prezantimin e Qarkores dhe KAB-it, duke thënë

se, sipas projeksioneve të buxhetit për vitin 2024 do të jenë 20 milionë e 034 mijë e 785 euro, për mallra dhe shërbime 2 milionë e 466 mijë e 340 euro, për subvencione dhe transfere 890 mijë euro, për shpenzime kapitale 6 milionë e 007 mijë e 462 mijë euro. Kërkesat e bizneseve dhe fermerëve kishin të bënin me investime kapitale, rregullim të rrugëve lokale, kanalizim, shenjëzim të rrugëve, meremetim të rrugëve, investime në sera, rrethrotullimi në fshatin Xërxë dhe Krushë të Madhe etj.



Komuna e Podujevës ia jep për shfrytëzim KRM “Pastrimit” kamionin për grumbullimin e mbeturinave



PODUJEVË, 22 QERSHOR - Komuna e Podujevës ka nënshkruar marrëveshje me KRM “Pastrimi”, për të ofruar në shfrytëzim kamionin i cili është pranuar donacion nga komuna e Linzit për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave në komunën e Podujevës. Nënshkrimin e marrëveshjes mes dy palëve e kanë bërë

drejtori i Shërbimeve Publike, Bahri Selimi dhe kryeshefi ekzekutiv i KRM “Pastrimi”, Petrit Reçica. Marrëveshja përmban ofrimin e kamionit për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave si formë mbështetjeje për KRM “Pastrimi”, në funksion të kryerjes sa më efikase të punëve dhe obligimeve ndaj qytetarëve sa i përket

menaxhimit të mbeturinave. Të dyja palët u zotuan se bashkëpunimi mes palëve do të thellohet, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave në komunën e Podujevës dhe përmirësimin e përgjithshëm të shërbimeve që ofron kompania për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Lagjja e Veternikut bëhet me Qendër të Mjekësisë Familjare



PRISHTINË, 22 QERSHOR - Nga sot e tutje të gjithë banorët e lagjes së Veternikut mund të marrin shumë shërbime mjekësore në Qendrën e re të Mjekësisë Familjare. Në këtë QMF nga stafi i përkushtuar i profesionistëve shëndetësorë në mjekësi familjare mund të kryhen shërbime vaksinimi, radiologji, mamografi si dhe mund të bëhen analiza laboratorike. Qendra e Mjekësisë Familjare

në Veternik ofron edhe shërbimin urgjent. Ky projekt u mundësua falë përpjekjeve kolektive, veçmas nga Drejtoria e Shëndetësisë e drejtorit të saj Izet Sadiku. Gjithashtu, në këtë ditë iu dha mirënjohje drejtorit të parë të QKMF-së, dr. Bajram Tahiri, dhe të gjithë të angazhuarve në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në zhvillimin e shëndetësisë në Prishtinë.

Asfaltohet aksi rrugor Ferizaj - Burrnik - Kashtanjevë

FERIZAJ, 22 QERSHOR - Kryetari i komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka përcjellë nga afër punimet e asfaltimit të aksit rrugor Ferizaj - Burrnik - Kashtanjevë. Aliu është shprehur se ky projekt infrastrukturor do t'u

mundësojë banorëve të zonës qarkullim më të lehtë, ndërsa pasionantët e natyrës do të kenë qasje më të lehtë në Bjeshkët e Pleshinës. “Aksi rrugor Ferizaj - Burrnik - Kashtanjevë po asfaltohet, në gjatësinë e dy segmenteve prej

10,5 km, për t'ua dhënë mundësinë banorëve të zonës për lehtësi në qarkullim e pasionantëve të natyrës për t'i zbuluar perlën natyrore të Bjeshkëve të Pleshinës e zonën e bukur të Burrnikut dhe Kashtanjevës”, ka njoftuar Aliu.



Sali Bislimi në Strasburg kërkon themelimin e një gjykate speciale për Serbinë për krimet në Kosovë

Prishtinë, 22 qershor - Drejtori i Zyrës Ligjore First-consulting.ch, veprimtari Sali Bislimi, ka vizituar Asamblesën Parlamentare të Këshillit të Evropës. Bislimi është takuar me shumë personalitete evropiane, presidentin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Tony Cox, përfaqësuesin e grupit të ALDE-s, Lulian Bulai, përfaqësuesit zviceranë Jean Pierre Grin dhe Alain Pierre Fridez. “Sot i ftuar në Këshillin e Evropës në Strasburg. Një shtytje për proceset e Kosovës. Nder dhe kënaqësi ta takoj presidentin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Tony Cox, përfaqësuesin e grupit të ALDE-s, Lulian Bulai, përfaqësuesit zviceranë Jean Pierre Grin dhe Alain Pierre Fridez e shumë personalitete të tjera”, ka shkruar Bislimi në “Facebook”. Ai ka treguar për temat që ka biseduar me këta zyrtarë

evropianë. “Mikpritja e ngrohtë më bëri të ndihem mirë, por temat që bisedova ishin që nga ky vend duhet të ngritet edhe një gjykatë speciale për krimet serbe në Kosovë, për një paqe afatgjate në mes të dy popujve. Kosova duhet të ketë sovranitetin politik dhe juridik. Talljet me në nuk i bëjnë mirë demokracisë. Përfaqësuesi i ALDE-s, Bulai me thotë se raportuesja për Kosovën znj. Dora Bakoyannis do ta stopon procesin e Kosovës në këtë institucion, ajo do të përpqet të mos lejoj një aleat të Turqisë ta anëtarësojë këtu. Zgjedhjet në veri të Kosovës nuk janë problemi, aty nuk thuhet problemi fundamental që vendet mike të Serbisë ose blloku ortodoks ballkanik bashkë me Rusinë synojnë zhbrerjen e shtetit të Kosovës. Kosova si kandidatë e anëtarësimit në Bashkimin Evropian meriton mbështetje



dhe uroj që politikat e gabuara të mos gjejnë përkrahje për një konflikt i cili do të ishte me pasoja të paparashikuara. Shqiptaret duhet të veprojnë si

komb që historia mos ta na përsëritet. Kosovë t'i njoh ëndrrat dhe vuajtjet. Nganjëherë po me ndalet fryma në sfidat e misionin tim për

vlrat perëndimore që meriton. E drejta është në anën tonë, do të dalim fitues vetëm të bashkuar! Me ty dhe për ty sa të jetoj”, ka shkruar Sali Bislimi.

Ndërron jetë dorëshkruesi i Deklaratës së Pavarësisë, Shyqri Nimani

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Të enjten ka ndërruar jetë akademiku, profesori, mjeshtri i artit, kaligrafisti i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, Shyqri Nimani.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, gjatë seancës së Kuvendit të enjten u ka shprehur ngushëllime familjarëve, shoqërisë dhe gjithë komunitetit të artit. “Mjeshtri i arteve të bukura, akademik Shyqri Nimani, na la sot. Një nga emrat më kulmor të artit në vendin tonë. Pas la një karrierë të bujshme dhe gjurmë artistike, nga krijimi i logos identifikuese të ‘Grand Hotel’-it, ‘Kosova Film’-it deri te simboli i Universitetit të Prishtinës. Me veprat e tij ka zënë me meritë të plotë e të padiskutueshme një vend nderi në listën e gjatë të krijuesve dhe



studiuësve të kohës sonë. Për 16 orë ka punuar për ta dorëshkruar aktin themeltar të shtetit tonë, Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Një njeri i rrallë, artist unik, shembull për angazhimin dhe kontributin e

vazhdueshëm për shoqërinë”, ka thënë Konjufca.

Ai ka thënë se Nimani, po ashtu, ishte një nga themeluesit e Departamentit të Dizajnit Grafik në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës, ndërsa ka botuar disa nga

monografite reprezentative dhe më të rëndësishme mbi trashëgiminë kulturore shqiptare. “Kontribut ka dhënë edhe në themelimin e institucioneve tona të artit. Ishte drejtori i parë i Galerisë Kombëtare të Kosovës. Në këtë ditë të vështirë për familjen, u shpreh ngushëllimet më të sinqerta atyre, miqve kolegëve dhe gjithë komunitetit. Përgjithmonë mirënjohës për veprat dhe krijimtarinë e tij të jashtëzakonshme artistike”, ka thënë Konjufca.

Edhe presidentja Vjosa Osmani i ka shprehur ngushëllime familjes Nimani dhe gjithë komunitetit akademik e kulturor për ndarjen nga jeta të dorëshkruetit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, profesorit e artistit Shyqri Nimani. “Me dhimbje të thellë e

pranova lajmin për ndarje nga jeta të dorëshkruetit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, profesorit e artistit Shyqri Nimani. Fjalët e skalitura nga ai në pergamenë janë testament për brezat që do të vijnë dhe kujtim i përhershëm për të. Për një kontribut të tillë, sikurse edhe atë në fushën e arteve, z. Nimani më 17 shkurt të këtij viti është dekoruar me ‘Medaljen Presidenciale të Meritave’. Ai ishte një intelektual i jashtëzakonshëm, pasioni dhe përkushtimi i të cilit frymëzoi studentë të panumërt. Veprimtaria e tij do të mbetet dëshmi e përkushtimit, pasionit dhe besimit të palëkundur në fuqinë transformuese të artit e të kulturës. Ngushëllime familjes Nimani dhe gjithë komunitetit akademik dhe kulturor!”, ka thënë Osmani.

Ekrem Hyseni zgjedhet kryetar i Degës së LDK-së

PODUJEVË, 22 QERSHOR - Ekrem Hyseni është zgjedhur kryetar i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Podujevë me mandat katërvjeçar. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, e ka pritur në zyrë Hysenin, të cilin e ka uruar për këtë pozitë. Edhe delegatët e degës dhe të gjitha strukturat e zgjedhura në Kryesi e Kuvend Qendror i ka uruar për një proces demokratik. “Pjesëmarrja e mbi 1 400 anëtarëve tanë në këtë proces delegimi e besimi, është shenjë

e qartë e një angazhimi të mirëfilltë strukturor. E besimi bindës në Ekremin, nga 90 delegatët të Kuvendit Zgjedhor, përveçse privilegj, duhet të shërbejë edhe si obligim për barrën që ai duhet të bartë përpara. Duke njohur Ekrem Hysenin nga afër, ashtu siç e njeh i gjithë Llapi, duke njohur mirësinë e tij si njeri, profesionalizmin si politikan, e vullnetin për angazhim ekipor, jam plotësisht i bindur për rrugën përpara”, ka thënë Abdixhiku.

Ai ka theksuar se Llapi po rikthehet si bastion burimor i Lidhjes; aty ku e kishte vendin gjithëherë. “Do të punojmë fort, do të punojmë mbarë, me Dokun e çdo patriot të djathtë për ta mbajtur LDK-në në hap me kohën”, është shprehur Abdixhiku.

Ish-kryetari i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu, ka reaguar për herë të parë pas zgjedhjes së Ekrem Hysenit kryetar i degës së kësaj partie në këtë komunë. Veliu ka thënë se procesi zgjedhor në



Degën e LDK-së në Podujevë nuk ka qenë i rregullt. “Një proces zgjedhor brenda Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Degën e Podujevës

ka kulmuar me Kuvendin Zgjedhor, ku u konfirmua e gjithë farsa zgjedhore e diriguar nga kryetari i degës dhe disa argatë të tij”, ka thënë Veliu.

Së shpejti fillojnë shpronësimet në rrugën Dragash - Brod

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se së shpejti do të fillojnë shpronësimet në rrugën Dragash - Brod. Aliu gjatë seancës parlamentare në Kuvendin e Kosovës ka treguar se tashmë ka filluar asfaltimi i dy shtresave të rrugës nga Zhuri në Dragash. "Projekti është i kontraktuar me dy lote. I pari është nga Zhuri në Dragash, loti i dytë është nga Dragashi me dy segmente Dragash - Brod dhe Tyrbe e

Pllavës - Zaplluxhë. Kemi filluar asfaltimin e të dyja shtresave në segmentin deri në Dragash. Për sa i përket pjesës së asfaltimit, ajo do të realizohet. Ajo se çfarë mbetet e porealizuar në këtë projekt është mungesa e kontratës së sinjalistikës, të cilën presim sa më shpejt ta realizojmë në mënyrë që të fillojmë në sinjalistikë dhe në shpronësimin për disa segmente që jemi duke u marrë seriozisht", ka shtuar

Aliu.

Ai ka treguar se ka vonesa të operatorëve për realizimin e punimeve. "E njëjta situatë është nga Dragashi për në Brod, për të cilën kemi premtimin se do të fillojmë shpejt shpronësimin. Problemet me operatorë ekonomikë janë jashtëzakonisht serioze, në shumë raste jemi të detyruar të arrijmë në pikën që duhet ta shkëputim kontratën", ka thënë Aliu.



Kërkohet rishikimi i buxhetit dhe rritja e pagave në sektorin publik

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Partia opozitare Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kërkuar të rishikohet buxheti i Kosovës dhe të bëhet rritja e pagave në sektorin publik. Këto kërkesa janë temat kryesore të interpelancës në Kuvendin e Kosovës më 22 qershor ndaj ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati.

Besnik Tahiri, shef i grupit parlamentar i AAK-së, ka kërkuar fillimin e menjëhershëm të procedurës për rishikimin e buxhetit për vitin 2023. Arsyeja për këtë, sipas tij, është për shkak të dështimit të plotë të investimeve kapitale dhe ngritjes së koeficientit të pagës në sektorin publik. "Menaxhimi i fondeve publike në këto dy vjetët e fundit nga Qeveria [e kryeministrit të Kosovës, Albin] Kurti, ishte i dobët, joprofesional, partiak e politik, mbi të gjitha ishte i dëmshëm për vendin", tha Tahiri. Sipas tij, në vitin 2021 nga fondi i investimeve kapitale, të përcaktuara në buxhet në shumë prej 622 milionë eurosh, janë realizuar vetëm 419 milionë euro.

Ndërsa për vitin 2022, sipas Tahirit, shuma për investime kapitale ka qenë 794 milionë euro, ndërsa janë realizuar vetëm 419 milionë euro. "Me dinamikën që e kemi në këtë vit, mund të pritët që ekonomia të bie në një kolaps dhe dështim të plot. Për dy vjet qeverisje Kosova



dhe kjo qeveri nuk kanë arritur t'i shpenzojnë gjysmë miliard euro", tha ai.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka kërkuar që koeficienti i pagës me rishikim të buxhetit të bëhet nga 105 euro në 129 euro. Në shkurt të këtij viti Kuvendi i Kosovës ka miratuar koeficientin e pagës.

Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, i cilësoi të pavërteta deklaratimet e deputetit Tahiri. "Sa i përket mbështetjes së ekonomisë u tha që ka pasur humbje dhe mosalokim të investimeve kapitale. Sa iu përket investimeve kapitale, normalisht që paguhen faturat për punët që janë kryer,

për projektet që nuk janë kryer punët ne nuk mund të paguajmë fatura", tha Murati.

Ai tha se gjithnjë duke qëndruar brenda kornizës ligjore për vitin e ardhshëm koeficienti i pagës do të rritet në 110 euro. "E konsideroj të panevojshme një seancë të tillë që kërkon të ndryshohet diçka për të cilën ne kemi shkuar në maksimum sa i përket vitit aktual", tha ministri Murati.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend Zemaj, tha se koeficienti i pagës prej 105 eurosh nuk i është përgjigjur as normës së inflacionit që, sipas tij, shënoi rritje rekorde. "Mos të harrojmë se sipas Bankës

Botërore, inflacioni në vendin tonë arriti deri në 20 për qind, ndërsa për produktet bazë 50 për qind. Përkundër sugjerimeve dhe propozimeve të ofruara nga ne dhe nga ekspertët, pushteti zgjodhi mosdëgjueshmërinë", tha ai.

Në deklarinë përmbyllës të interpelancës, deputeti i AAK-së, Besnik Tahiri, tha se shuma e nevojshme për rritjen e koeficientit të pagës është 85 milionë euro, të cilat mund të merren nga kategoria mallra dhe shërbime. "Me zbritjen e kësaj kategorie do të ketë rritje të pagave dhe nuk do të preken parimet themelore të buxhetit, do të ruhet rregulla fiskale, do të ruhen stabiliteti dhe

qëndrueshmëria fiskale dhe do të përmirësohet standardi i të punësuarve, që janë buzë shkatërrimit. Mbi 80 mijë njerëz presin të reflektoni për rritje të koeficientit nga 105 në 129 euro", tha Tahiri.

Rishikimi i buxhetit bëhet zakonisht në gjysmëvjetorin e dytë të vitit, respektivisht në muajin qershor. Ky rishikim ofron mundësi për transferime ndërmjet nënprogrameve dhe organizatave buxhetore. Organizatave buxhetore u lejohe të bëjnë rregullime të brendshme që janë të arsyeshme për ta bërë ekzekutimin efikas të buxhetit për periudhën e mbetur të vitit buxhetor.

Gjiganti metalurgjik rinis prodhimin pas dy vjetësh

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Teksa qëndron përballë metalit të shkrirë që derdhet nga një furrë gjigante, Sylejman Hajdari, 60 vjeç, thotë se kjo pamje po e lumturon.

Hajdari ka mbi 40 vjet përvojë pune në korporatën metalurgjike në Drenas, NewCo Ferronikeli Complex LLC, e cila prodhon dhe eksporton nikel nëpër shumë vende të botës. Kjo kompani

ndaloi prodhimin më 8 tetor të vitit 2021 për shkak të shtrenjtimit të energjisë elektrike në Evropë duke rrezikuar punën e mbi 2 000 punëtorëve. "(Jam ndier i frikësuar) sepse një karrierë e gjatë, të të ndërpritet puna para pensionit, nuk është bash mirë", thotë Hajdari.

Prodhimi u rikthye të mërkurën, më 21 qershor, pas rreth tri javësh parapërgatitje

për rindezjen e makinerive. "Jemi gëzuar shumë se edhe më është mësuar trupi të punoj. 40 vjet [punë]", shton Hajdari.

Ferronikeli ka qenë kompani publike para se të privatizohej në vitin 2005. Në vitin 2018 ajo është blerë nga kompania e Shqipërisë "Balfin Group". Rreth një vit më parë ajo kaloi në pronësi të konsorciumit turk "Yildirim Group".



Rexhep Qosja, krijuesi i madh në universin kombëtar shqiptar



Prof. dr. Kudusi LAMA,
gjeneral në pension

Njeriun e bëjnë të përjetshëm veprat e tij.

Sami Frashri

Gjeniu i ngjan çdokujt, atij askush.

Balzaku

Nëse njeriu e zbraz kuletën e tij në kokë,

askush nuk mund t'ia marrë

Benjamin Franklin

Kur din diç, të tregosh që e di, dhe kur nuk din diç,

të tregosh që nuk e di, kjo është dituri

Konfuçi

Hyje

Ata që dinë, veprojnë.

Ata që kuptojnë, i mësojnë të tjerët

Aristoteli

Fisnikja dhe fisnikëria janë ulur në portretin e Rexhep Qosjes. Aty është ulur forca, qetësia, dhe madhështia, duke e bërë atë portret të madh dhe ndriçues për të gjitha kohërat. Në ligjërimet dhe shkrimet e tij na vjen qartësia e të ardhmes, na paraqitet rruga drejtë lumturisë universale, na paraqitet perandoria e lirisë dhe e barazisë për të gjithë. Ai, gjithnjë si një perandor i pathyeshëm, na mëson se asgjë nuk lind nga asgjëja, por çdo e mirë vjen nga përkushtimi, bashkimi dhe qëndresa e palëkundur para çdo të keqeje. Fjala e tij vjen në çdo rast e gdhendur, për të zënë vendin e saj të palëkundshëm në kështjellën e lartë të mendimit të përparuar njerëzor.

Duke studiuar veprën e Qosjes, kupton se ai trason rrugë të qëndrueshme për brezat që vijnë pas tij. Nuk punon sot për sot. Ai ndërton për përjetësinë, duke ua mësuar të gjithë atyre që vijnë pas se cila është rruga e përparimit njerëzor, rruga e paqes dhe mirëkuptimit njerëzor.

Hapat e para dhe shpaloja e ideve të mëdha

Bëhu i sigurt që e ke vënë këmbën në vendin e duhur, pastaj qëndro i palëkundshëm

Abraham Lincoln

Akademik Rexhep Qosja i përket asaj plejade që nuk e gjetën rrugën e mendimit të shtruar - ai është në

atë formacion të mendimit kombëtar e njerëzor që e ndërton atë mendim, i themeluan dhe i zhvilluan idetë e përparimit. Prandaj, në të sotmen, e kemi për detyrë ta studiojmë atë mendim dhe ta shfrytëzojmë për interesat e zhvillimit dhe përparimit, edhe duke mos qenë dakord me elementë që nuk na shkojnë për shtat në kohët tona, por gjithnjë duke vlerësuar se kjo vepër është madhore dhe me shumë vlerë, jo vetëm për kombin shqiptar por për të gjithë kombet që aspirojnë për dinjitet e përparim. Kjo sepse sot ne e kemi të qartë qëllimin, sepse të qartë na e ka bërë vepra e Qosjes dhe paraardhësve e bashkëkohësve të tij. Prandaj, çdo hap ta bëjmë ta palëkundshëm dhe të pakthyeshem në rrugën drejtë zhvillimit.

Profesor Qosja ka shpallur një vepër që krijon hapësirë diellore të arsytimit teorik, por njëkohësisht është kaq e thjeshtë për ta ulur në terrenin e zbatimit praktik. Sepse ai ka ditur çfarë bën. Në asnjë çast të jetës së tij nuk është përhapur në drejtime të ndryshme, por ka trasuar një rrugë dhe e ka bërë të pakthyeshme dhe të pathyeshme, duke ngulur thellë në këtë rrugë rrënjët e idesë së çlirimit, të bashkimit dhe të dinjitetit kombëtar shqiptar, duke dhënë modelin edhe për çdo komb që aspirojnë të jetë i lirë, i bashkuar dhe i zhvilluar.

Ashtu sikurse me mendimin e tij, me maturi tërheq vëmendjen për çdo dukuri që na pengon në rrugën e zhvillimit. Kritika që bën ai e arsyeton fuqishëm qëllimin, që njerëzit të bëhen të matur, që qeveritarët të largohen nga keqpërdorimi i fuqisë që u japin ligjet e qeverisjes, si dhe të shërbehet me përkushtim për të ndryshuar e përmirësuar gjendjen ekzistuese. Këtë Qosja e kërkon me ngulm, duke treguar edhe rrugën se si mund të zgjerohet fusha e zhvillimit, duke luftuar me forcë mendjemadhësinë, lakminë, egoizmin, zilinë dhe keqdashjen, si lodra të së keqes, që na e shtrembërojnë rrugën e zhvillimit dhe dobësojnë autoritetin e kombit në familjen e kombeve të qytetëruara.

Profesor Qosja është përqendruar për të bërë punën e tij, duke dhënë shembullin më të përsosur, se si njeriu, duhet të jetë i suksesshëm në jetë. Pasi, kur shpërndahemi duke marrë përgjegjësi të dimë gjithçka, nuk dimë të bëjmë asgjë si duhet, si dhe pengojmë të tjerët të bëjnë atë që dinë e duhet të bëjnë.

Mosmarrëveshja e Qosjes

Askush nuk është aq i pasur, sa të mund të blejë të kaluarën e vet

Oscar Wilde

Me pushtetin qeverisës, siç duket, Qosja nuk e ka pasur në asnjë rast



të mundur të merret vesh. Dhe kjo për një arsye shumë të thjeshtë: sepse ai nuk arrin ta kuptojë se si është e mundur që ata të cilët kanë në dorë pushtetin kanë fjalë më shumë se ata që janë përballë për të vlerësuar qeverisjen e tyre, që në gjuhën parlamentare e quajnë opozitë? Ai kërkon që opozita të flasë fortë, por të shpallë pasqyra zhvillimi, jo të bëjë rolin e gjykatësit a policit. Ndërsa ata që qeverisin të punojnë e të mos flasin fare. Puna e qeverisësve flet vetë, nuk ka nevojë as për mbrojtje, as për marketing, as për arsytim. Kaq kërkon Qosja. Por ata që duan të qeverisin pa u lodhur dhe ata që duan të bëjnë opozitarizëm pa program, nuk duan ta pranojnë këtë. Ndërsa, Qosja nuk mund të bëjë lëshime, prandaj në shumë raste gjenden në fronte përballë. Por duhet ditur se kjo nuk i sjellë pasoja Qosjes. I sjellë pasoja atdheut dhe atyre që qeverisin keq e që nuk duan të jenë të ndershëm me detyrën që marrin përgjegjësi ta kryejnë. Sikur të kishte qeveri dhe opozitë e të mos kishte popull, do të ishte e plotë ajo që bëjnë ata. Por ja që është populli, i cili, një ditë do t'i nxjerrë të tepërt këtë kategori qeverisësish, duke e kuptuar e vlerësuar

plotësisht qëndrimin e palëkundur të Qosjes përballë tyre.

Koha jetësore dhe mosnxitimi i Qosjes

Ka vetëm një të mirë: dituria. Dhe vetëm një të keqe: padituria.

Sokrati

Akademiku Qosja, në jetën e tij vërehet se ka pasur dhe ka një synim të prekshëm: të jetë njeri i veprimit, të jetë i dobishëm për shoqërinë, për atdheun dhe kombin e tij, duke bërë të gjitha përpjekjet të jetë sa më i qartë dhe me një vepër të prekshme e të kuptueshme.

Kuptohet se të flasësh me profesorin do të thotë që ai të ketë një pamje të kthjelltë të asaj që trajtohet edhe në procesin e mëtejshëm. Kur përballë tij flitet për një kohë shumë të shkurtër, ai ka mundësi intelektuale të dijë se deri ku do të arrij trajtesa përkatëse, duke mos e parë të arsyeshme të harxhojë kohë për të marrë pjesë në diskutim. Edhe ky është një tregues për të na bindur se sa me vlerë është koha jetësore e profesorit.

Ai nuk bën asgjë me nxitim, nuk bën asgjë me koncepte

sipërfaqësore, nuk bën asgjë jashtë veprimit natyror, përkundrazi, në gjithë veprimtarinë e tij mbisundon qetësia dhe përpjekjet për të depërtuar në thelbin e çështjeve. Por këto paraqitje të profesorit Qosja në mjaft raste bëjnë që paaftësia të bezdiset, të humbasë durimin, sepse duke mos arritur te ai, shfaq mosdurim, për tentativën e mendimit të tij drejtë përsosmërisë. Megjithatë profesori ka të qartë atë fjalën e urtë të popullit, se, kush futet nëpër ferra do të shpohet nga gjembat. Ndaj ka vendosur që me gjithë veprën e tij, t'i qëndrojë besnik botës së tij shpirtërore, sepse ai do që veprën e tij ta lerë të qartë për të sotmen dhe të ardhmen – të afërt dhe të largët. Kështu ai ka edhe qartësi në shpirt: sikurse duke krijuar një vepër të madhërishtme, ka paraqitur edhe karakterin e tij të madhërishtëm.

Edhe kundërshtarët

Keni armiq? Në rregull. Kjo do të thotë që keni mbrojtur një kauzë në jetën tuaj.

Winston Churchill

Kundërshtarët e tij është e kuptueshme që nuk do të shuhen,

sepse disa prej tyre përtojnë ta lexojnë veprën e tij, nuk e njohin fare dhe për të mos e lodhur veten, thjeshtë nuk duan të kenë të bëjnë me të, ndaj do ta quajnë të pa kuptueshme, pa kuptuar se shpalosin budallallëkun e tyre. Por, me të tillët Qosja nuk merret fare, sepse e kupton se ata aq dinë aq bëjnë. Disa të tjerë madje janë ziliqarë, të cilët jo rrallë hapur e shprehin inatin: pse fuqia e mendimit duhet të jetë e Qosjes dhe jo e tyre? Të tillët do ta nderonin shumë atë po të ishte një njeri me mendime të nivelit të ultë. Një kategori e kundërshtarëve të tij shprehin revoltën e tyre që nuk arrijnë dot që me punën e tyre ta lënë pas vetes atë.

Sikurse duhet të jemi të mirëkuptuar edhe me faktin që edhe Qosja është njeri, si gjithë të tjerët, prandaj nuk është i imunizuar nga dobësitë a gabimet. Por, siç kam konstatuar, gjithmonë kritikën rëndom kanë ardhur me vonesë, çka do të thotë se kritikët e Qosjes janë paraqitur pasi dobësitë a gabimet janë tejkaluar dhe korrigjuar. Kështu që edhe këta kundërshtarë kritikë të vonuar bëhen të panevojshëm, pasi thjeshtë bëjnë zhurmë. Ka edhe një pjesë tjetër të kundërshtarëve që veten e quan të përsosur dhe çdo mendim ndryshe, për ta është i pa vlefshëm dhe i duhet qëndruar përballë. Kjo kategori që nuk e kuptojnë se ashtu siç janë të ndryshme portretet janë të ndryshme edhe mendimet. Por me gjithë paraqitjen e kategorive të kundërshtarëve, Qosja ndihet i plotësuar, sepse ka dy fuqi pas vetes: Së pari, mbështetësit e tij janë masiv në mesin e shqiptarëve dhe të qytetarëve të kombeve të tjera; së dyti, vepra e tij teorike është një vepër që më shumë se çdo vepër tjetër është aplikuar në terrenin e atdheut dhe në hapësirat e kombit shqiptar, saqë është kthyer në një busull orientuese për të gjitha kombet që aspirojnë të nesërme të sigurt.

Edukimi atdhetar

Edukimi i mendjes pa edukimin e zemrës nuk është aspak edukim.
Aristoteli

Detyra e parë që vë Qosja në veprën e tij është çështja e edukimit atdhetar. E, për këtë ai ka studiuar me shumë vëmendje njeriun shqiptar me gjithë universalitetin e shfaqjes së tij, duke përcaktuar normat e nevojshme të mendimit të qëndrueshëm, pa e parë çështjen në interesin e përkohshëm, por në atë afatgjatë dhe të perspektivës së largët të së ardhmes. E, për këtë, ai ka arritur të përcaktojë mesazhet e ballafaqimit të karaktereve, për të edukuar vetitë e shkathtësive jetësore duke u vënë përballë situatave të vështira të jetës kombëtare.

Gjithashtu, Qosja ka ardhur në përfundimin se, që të kesh fuqi të emrit dhe portretit, nuk duhet të jesh i prirë për të bërë para, sepse paraja dhe autoriteti nuk shkojnë

bashkë. Është për të ardhur keq që, njerëz me emër, të cilët ngjiten deri në nivelet më të larta të qeverisjes, vetëm pse vrapojnë pas pasurimit të shpejtë, ndoshta edhe të paligjshëm, sapo të largohen nga postet që mbajnë, as që dihet nëse kanë jetuar a ekzistuar ndonjëherë. Pasi sipas vlerësimeve që kemi mësuar, paraja e madhe e zhbën autoritetin.

Prandaj, edhe profesor Qosja, gjithë jetën e tij, në përpunimin e veprës, ka ndërtuar qëndrimin serioz ndaj interesit të përgjithshëm të kombit e të qytetarisë, pa bërë përpjekje të nxjerrë në pah veten, për ta zënë një vend sa më të mirë në shoqëri, pasi atë e ka konsideruar prirje të rreme dhe nuk ka dashur që ajo të zërë vend në personalitetin e tij, duke mos u bërë kurrë pjesë e atyre individëve që kërkojnë me çdo kusht të tregojnë shkëlqimin e tyre, pa marrë në konsideratë vlerat mbi të cilat duhen mbështetur dhe parimet e të përgjithshmes. Ndërsa Qosja edhe vesin është përpjekur ta tregojë lakuriq, ashtu siç paraqitet, për ta paralajmëruar shoqërinë për dukjen e tij dhe për ta bërë të qëndrueshme atë para dukurive të tilla tragjike që e dëmtojnë kombin dhe zhvillimin shoqëror.

Përballë kritikës historike

Parimisht, janë dy lloje njerëzish. Njerëzit të cilët kryejnë punët dhe njerëzit të cilët deklarojnë se kanë kayer punët.

Grupi i parë është grumbull më i vogël.

Mark Tuen

Tërheq vëmendjen fakti që në pasqyrën e veprës së tij Qosja ka vetëm shpëtimtarët e kombit shqiptar dhe ata që kanë shpëtuar kombet e tyre në gjithë botën. Ai është i gatshëm të qëndrojë edhe përballë kritikës historike, siç edhe ka qëndruar stoikisht, për t'i mbajtur të pastër ata nga njollat që përpiqen t'ua veshin, që nga Teuta e lashtë, Skënderbeu i mesjetës, rilindësit e lavdishëm, udhëheqësit e luftërave të bërjes së shtetit shqiptar, e deri te luftëtarët e udhëheqësit e Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe luftërave çlirimtare në Kosovën Lindore e në Maqedoni. Ka qëndruar vazhdimisht përballë atyre që janë përpjekur e përpiqen t'ua heqin një vizë të zeze ngjarjeve të mëdha të historisë kombëtare, pasi duket se çdo tentativë e tillë e bën që t'i dhëmbë shpirti.

Fuqia e fjalës, e idesë dhe e mendimit

Sekreti i suksesit është këmbëngulja për arritjen e qëllimit.
Benxhamin Dizraeli

Duke i perceptuar problemet e botës në tërësi dhe të botës shqiptare në veçanti, Qosja ka bërë përpjekje t'i njohë ata deri në hollësi, për të dhënë edhe idetë e zgjidhjeve të mundshme. Kjo e bën Qosjen edhe një psikolog të shpirtit kombëtar, pasi shihet se ka depërtuar deri në thellësi të tij,



duke krijuar pamjen e plotë të prithmërisë së të ardhmes. Ndërsa për politikën dhe diplomacinë, në veprën e tij ai ka apeluar gjithnjë për bashkëpunimin midis kombeve, pasi rekomandon se ata zhvillojnë njëri-tjetrin dhe korrigojnë gabimet e njëri-tjetrit, por gjithnjë kur ka mirëkuptim e nderim të ndërsjellë.

Që ta kuptosh Qosjen duhet t'ia studiosh veprën. Të nderosh Qosjen duhet t'ia dëgjosh e vlerësosh fjalën. Veprën e vet ai e ka shkruar për ata që e studiojnë, jo për ata që e shikojnë. Prandaj, edhe do të rekomandoja që kush merr përgjegjësi të flasë për Qosjen e ka obligim ta studiojë me përkushtim veprën e tij dhe pastaj mund të bëjë kritikën e thelluar për ta pasuruar e përmirësuar atë më tej.

Por, këtë e bëjnë dhe mund ta bëjnë vetëm ata studiues, të cilët dëshirojnë dhe kërkojnë atë rrugë të cilën e ka trasuar ai, për të arritur në synimet e dëshiruara. Sepse, në fund të fundit, siç ka thënë Gëte "duhet të jesh dikush që të mund të bësh diçka".

I bindur pas të vërtetës

Të flasësh dhe të shkruash të vërtetën është arti më i rëndë nga të gjitha artet.

Gorki

Rexhep Qosja është shpirti që është i dashuruar pas të vërtetës dhe të madhërishtes. E për këtë ai i ka zhvilluar në vijimësi aftësitë e tij të trashëguara, duke thithur me etje ndikimet e botës, duke

përvetësuar ato elementë që i janë nevojitur për të ndërtuar veprën e tij. Dhe për të vërtetën ai ka folur vazhdimisht pavarësisht nga sfidat. Sepse ka kuptuar se predikimi i të rremes me të cilën është ndeshur, është sëmundje e shoqërisë dhe kombit, megjithëse ajo bën përpjekje të dalë shpesh në krye dhe të ndihet e sigurt, pasi është më e lehtë për t'u përvetësuar e rremja se e vërteta. Por, Qosja i ka vënë vetes mision të flasë vazhdimisht për të vërtetën, duke luftuar pa u ndalur predikimin e të rremes, si dhe duke bërë përpjekje ta pastrojë të vërtetën nga e rremja, pasi ato shpesh edhe vijnë bashkë. E gjithë kjo e bën Qosjen një njeri të mirë, prandaj edhe të madh në universin kombëtar shqiptar, në të gjitha fushat e studimit e të zhvillimit, pasi duke qenë i mirë

dhe me talent ka arritur të krijojë ndikimin pozitiv në kombin shqiptar e edhe në shoqërinë në tërësi. Kështu, ai gjithnjë është vigilent për të mos lejuar që asgjë t'i kalojë nga moskokëçarja e as nga zemërgjerësia.

Vepra që për t'i kuptuar duhet t'i studiosh

Me anë të vlerësimit, e bëjmë përsosmërinë e të tjerëve pronën tonë.
Volteri

Profesor Qosja ka krijuar vepra që për t'i kuptuar duhet t'i studiosh. Dhe vetëm duke i studiuar do të arrijmë të kuptojmë çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë ajo punë, ai veprim apo ndërtuar ajo vepër kombëtare, që të jetë e qëndrueshme në të ardhmen e afërt dhe të largët. Ai nuk ka krijuar vepra për ata që nuk duan të lexojnë, as për ata që nuk duan të kuptojnë.

Ashtu sikurse duhet pranuar se ndikimi i veprës së Qosjes mbi universin kombëtar shqiptar është shumë i natyrshëm dhe i sjellë dobi të mëdha procesit të ngjitjes në horizontet e krijimit të vlerave, duke u ndeshur me vështirësitë dhe dhunën e kundërshtive, për të ruajtur anën më të mirë të natyrës sonë. Dhe këtë e ka bërë duke u mbështetur fortë në tokë, pa iu nënshtuar ndikimeve të jashtme për ta marrë nën pushtetin e tyre. Sepse ka bindjen e plotë se shqiptarët, që në lashtësinë e tyre, janë vendosur në këto troje për arsye se u kanë pëlqyer, sepse janë pajtuar me to, sepse janë dashuruar pas tyre dhe se këto troje kanë qenë dhe janë në ujdi me karakterin e lindur të tyre. Prandaj edhe gjithë vepra e profesor Qosjes është ndërtuar duke përdorur mjetet reale në mënyrë të tillë, që e vërteta e pasqyruar të jetë pa dyshim e vërteta reale, pasi ai, në radhë të parë, ka bërë përpjekje të njohë vetveten ... dhe mendoj se ia ka arritur ta njohë atë.

Megjithëse njohja e vetvetes është një kërkesë që është e vështirë të realizohet, sepse ëndrrat dhe synimet e tij janë drejtuar për ta njohur botën, për ta njohur mjedisin që na rrethon, si dhe për ta njohur shpirtin veprues, prandaj kjo përpjekje për ta vënë gjithçka në shërbim të qëllimeve të veprës së tij, bën që ai të gëzojë dhe të vuaj njëkohësisht, e nëpërmjet gëzimeve dhe vuajtjeve ai ka arritur të bëhet udhërrëfyes për kombin dhe për qytetarinë, duke shmangur të gjithë elementët që kanë tentuar t'i zënë rrugën për ta penguar.

Sa më larg nga zhurma

Idetë e mëdha shpesh pranojnë kundërshtime të dhunshme nga mendje të mesme.
Albert Ajnshtajni

Profesori gjithnjë ka kërkuar dhe kërkon që, secili të jetë jo vetëm shfrytëzues i asaj që krijojnë të tjerët, por edhe zhvillues dhe

fuqizues të asaj që mësojmë a që trashëgojmë. Sepse nëse do të jemi thjeshtë shfrytëzues, kur të vijë çasti t'i kthejmë kohës atë që është e saj, kuptojmë se jemi shumë të varfër, por tashmë është vonë për ta kthyer rrjedhën. Ai na këshillon të kuptojmë se bota nuk ka filluar me ne dhe nuk ekziston për hir tonin; se dielli ka lindur e do të lind përjetësisht, jemi apo nuk jemi ne; se dita dhe nata do të zëvendësojnë njëra tjetrën përjetësisht; se brezat do të zëvendësojnë njëri-tjetrin, si ajo spiralja që vjen gjithnjë në ngjitje të vazhdueshme dhe që jeta pasurohet, zhvillohet dhe zgjerohet vazhdimisht, pavarësisht prej nesh. Ne mund të japim kontributin tonë, por duhet të jemi të kujdesshëm që atë gur në kështjellën jetësore ta vendosim atje ku duhet dhe ashtu si duhet, se në të kundërt do të vije dikush e do ta hedhë në humnerën e kohës, duke riparuar defektin që kemi shkaktuar ne me veprën tonë të gabuar, dhe kështu nuk na mbetet më asnjë gjurmë. Prandaj, profesori kërkon të qëndrojmë larg ndjenjës egoiste, thjeshtë për të dalë në pah si ato orkestrat që bëjnë aq zhurmë sa nuk lënë të dëgjohet asnjë fjalë nga kënga e këngëtarit të cilit është vënë t'i shërbejë. Zhurma mbetet zhurmë, dhe pasi të kalojë, ata që janë shqetësuar prej saj kuptojnë se nuk kanë dëgjuar e as kuptuar asgjë. Të mos biem në të tilla nivele sa të mos themi asgjë, por thjeshtë të shqetësojmë të tjerët. Ky është një mesazh që ia vlen ta kuptojmë të gjithë.

Pjesëmarrës i të gjitha zhvillimeve të mëdha

Çdo ditë e jetës sate është një faqe e biografisë sate, andaj kujdesu të shkruash mirë, sepse një faqe e keqe e ndyn gjithë librin!
Sami Frashëri

Dhe Qosja gjithnjë ka dhënë këshilla të vlefshme, duke vënë në pah synimet më të qarta e të detyrueshme për ecjen kombëtare e qytetare, pavarësisht nga ekzistenca edhe e zhvillimeve absurde, të cilat jo gjithnjë janë të shmangshme. Por, edhe të tilla zhvillime, atij nuk kanë arritur t'ia zbehin dëshirën për të bërë detyrën e tij të këshilltarit të urtë. Ama, duhet të kemi të qartë se, Qosja nuk është një këshilltar pasiv. Ai është pjesëmarrës i të gjitha zhvillimeve në terrenin praktik. Dhe kjo e bën shumë më të fuqishme këshillën e tij, pasi ai e ka peshuar mirë atë që rekomandon të realizohet, sepse punon vetë për ta realizuar dhe nuk është soditës i jashtëm i praktikës së këshillave të tij. Kjo ka bërë që ai gjithë jetën ta ruaj nivelin e punës së tij në lartësinë e mençurisë së lartë, duke mos pasur asnjë luhatje apo ulje-ngritje në rrugëtimin e tij të gjatë të krijimit, në universin kombëtar shqiptar.

Me rëndësi është që bota të shihet drejtë, qartë, kthjelltë, me qëllim që përmendoret e krijuesve, të cilat na i lënë si trashëgim nëpër histori, të

jenë produkt i vullnetit të mirë, të jenë prodhim i shikimit të mprehtë dhe të jenë ndërtuar pa paramendime të caktuara. Mendoj se këtë e ka bërë mjaft mirë profesor Qosja, i cili ka bërë që e shkruara e tij, duke qenë e drejtë për kohën e lindjes së saj, do të mbetet e drejtë edhe në përjetësi, për të mbetur si gur i gdhendur saktë në murin e kështjellës kombëtare e qytetare. Prandaj, edhe është detyrë jona ta pasqyrojmë bindshëm e me vërtetësi butësinë e pikëpamjeve të tij, qartësinë, forcën e shpirtit të tij, gjithë madhësitinë e këtij njeriu të jashtëzakonshëm, që ka krijuar epokën e tij.

Përjetësisht në sprovë të kohës

Asnjë s'mund të të bëjë të ndihesh inferior pa lejen tënde.

Eleanor Roosevelt

Edhe një bisedë me akademik Qosjen është e shumanshme, siç është edhe vepra e tij. Ai është i palëkundur, gjithmonë i njëjtë dhe gjithmonë në prodhim të ideve të reja për të tashmen dhe të ardhmen, duke u paraprirë zhvillimeve historike, politike, kulturore dhe qytetare. Idetë e tij të reja rrjedhin paprerë, janë vijimësi, janë një lumë i pashtershëm. Ligjërimit i tij gjithnjë është i qetë, i pa ndërprerë, i kuptueshëm, duke respektuar edhe pikat e presjet, për të shqiptuar mendimet më të matura, me fjalët më të gjetura, për

të shpërfaqur gjithë pasurinë që ruan natyra e tij, duke bërë që në një bisedë të gjallë ai të jetë gjithnjë i shkëlqyer dhe i pagabueshëm. Qosja ka arritur nivelin më të lartë të përqendrimit mbi çështjet që analizon. Kjo mënyrë përqendrimi është bërë një tipar dallues i karakterit të tij. Prandaj ai është gjithnjë edhe zot i lëndës që trajton, duke u dhënë veprave të tij përsosmërinë. Por dihet që madhështia është edhe burim mundimesh e vuajtjesh, prej të cilave as profesor Qosja nuk mund të ikë, pasi realisht i lumtur është ai që nuk e njih askush e që kënaqet me vetveten. Por profesori ka zgjedhur të ngjitet në lartësitë e thepisura për të qenë përjetësisht në sprovë të kohës.

Vepra e Qosjes, "eksploziv" që hap shtigje në terrene të vështira


E pamundura është një fjalë që mund të gjendet vetëm në fjalorët e budallenjve.
Napoleon Bonaparti

Prandaj do të rekomandoja që të studiohet fuqia dhe përmasat e atij fenomeni që quhet Qosje, pasi ata që do të merren me këtë, do të tregojnë se kanë talent, pasi nuk mund të kalohet pa e vënë re Qosjen, nuk mund të mos studiohet ai. Dhe duke e studiuar secili do të bindej se Qosja e ka kuptuar plotësisht të mirën njerëzore, pasi ka studiuar e njohur edhe natyrën njerëzore,

me gjithë larminë e zhvillimit të saj, si dhe ka vënë në pah edhe vlerat e kombit të cilit i përket në këtë larmi përplasjesh, kundërshtish e zhvillimesh. Të studiohet sepse vlerësoj se vepra e tij është si eksplozivi, që hap shtigje në terrene të vështira.

Unë e di se me Qosjen jo të gjithë njerëzit janë të kënaqur dhe jo të gjithë duan ta shohin ashtu siç është. Për rrjedhojë jo të gjithë kanë mbetur të kënaqur edhe me veprën e tij. Megjithëse me sa e kam studiuar unë veprën e tij, ai gjithë jetën është përpjekur me gjithë shpirt që t'i ndihmojë njerëzit me atë vepër. Por ja që ka njerëz të cilët nuk e gjejnë zgjidhjen në atë vepër sipas pikëpamjes së tyre. Dhe unë këtë e pranoj si të drejtë, por nuk pranoj mospajtimin pa argumentuar kundërshtinë. E për këtë deri sot ka pasur vetëm një diskutim që është quajtur debati Qosja – Kadare, i cili, sipas mendimit tim, ia ka vleftur. Ndërsa më tej, unë nuk e kam gjetur kritikën për veprën e Qosjes, përveç kundërshtitë a mosdashje thjeshtë për ambicie të sëmurë ose smirë.

Gjithashtu, ajo që vërej unë është se Qosja është në paqe me veten, në paqe me familjen, në paqe me shokët, në paqe me shoqërinë, në paqe me atdheun, në paqe me kombin, duke ecur nëpër jetë pa kërkuar prej askujt mirënjohje, por duke dhënë mirënjohje për të gjithë ata që bëjnë vepra të mira për interesat e atdheut, të kombit dhe të shoqërisë në tërësi.



Qosja ia di vlerën veprës që ka punuar

Fuqinë e mendjes e ke ti, jo ngjarjet jashtë.

Kupto këtë, dhe do të gesh forcë.
Mark Aureli

Duhet thënë njëkohësisht se Qosja është shumë modest, por ia di vlerën veprës që ka punuar. Nëse dikush e konsideron veprën e tij të padurueshme, mos ta kërkojë fajin te Qosja, por te vetvetja që nuk është në gjendje të kuptojë çfarë është shkruar dhe çfarë kërkohet. Ashtu sikurse ndoshta dikush ka dëshirë ta shohë atë që të shqiptojë me përvujtëri fjalë modeste, për vlerësimet që i bëhen për veprën. Këtë nuk duhet e nuk mund ta kërkojë askush nga Qosja. Të kemi të qartë se, njeriu i ngjan mjedisit ku ka lindur, e ai ka lindur midis maleve kryelartë dhe aheve e pishave shtatlartë, prandaj nuk ka pasur ku ta gjej përulësinë. Prandaj ai nuk mund të veprojë e të paraqitet në kundërshtim me natyrën e tij, se do të ishte një i mjerë, dyfytirësh e gënjeshtar. Prandaj, ai është aq i fortë sa të shfaqet ashtu siç është në të vërtetë, ani pse ndonjëri do të thotë se ai është mendjemadh.

I dashuruar me lirinë

Dashuria për atdheun është topi që shkatërron kalatë më të forta dhe kalaja që mund t'u qëndrojnë topave më të fortë.

Sami Frashëri

I dashuruar me lirinë, Qosje është armik i betuar i arbitraritetit, prandaj edhe i bindur se për lirinë duhen bërë sakrifica sublime. Qosja në vijimësi ka dhënë mesazhet e organizimit dhe të luftës për ta fituar lirinë kombëtare për shqiptarët dhe të gjithë popujt që shtypen e shfrytëzohen dhe

masakrohen nga pushtuesit. Ai kërkon që edhe ndërtimi i shtetit të tij të jetë në çdo gjë i drejtë, i mirë dhe i arsyeshëm, duke mos bërë asgjë që të kundërshtohet nga qytetarët e vendit a të jetë në dëm të tyre. Por, ai nuk bëhet kurrë as mik i shtetit të tij nëse krahas shumë të mirave ka edhe shumë të këqija, shumë padrejtësi dhe papërsosmëri, sepse nuk pranon të bëhet mik i së keqes. Kështu ai edhe shpesh vihet në shenjë nga ata që marrin pushtet, sepse nuk janë në gjendje të krijojnë atë shtet siç e rekomandon ai. Pasi prej tyre nuk merret në konsideratë fakti që koha lëvizë përjetësisht përpara dhe kërkesat e qytetarëve janë gjithnjë në rritje, sepse diçka që në vitin 1999 ishte e mirë në vitin 2023 nuk vlen.

Të mbajmë në vëmendje se, është thënë që kombi ka karakteristikat e tij, vlerat e tij, shpirtin e tij, thelbin e tij, prandaj edhe nevojat e tij duhet të dalin prej këtyre karakteristikave. Asgjë më shumë se kaq nuk kërkon Qosja prej shqiptarëve dhe të tjerëve. Ne nuk mund të ndërtojmë në vendin tonë kopjet e vjetra të të huajve. E kjo është një dobësi që po vërehet, pasi nuk merret në konsideratë se ajo që për një popull a një shtet mund të jetë e mirë, për ne, për shtetin tonë e për popullin tonë mund të jetë e keqe. Kështu që, përpjekjet për të thithur përvojat e huaja, pa qenë nevojë e lindur nga thelbi i kombit, janë të pasuksesshme.

Gjykatës i paanshëm dhe lider si një institucion

Sa më shumë e mendoj aq më shumë e kuptoj që s'ka asgjë më artistike se sa të duash të tjerët.

Vincent Van Gogh

Vlerësoj gjithashtu se Qosja

gjithnjë ka ruajtur baraspeshën, edhe kur ka vlerësuar talentet, zhvillimet, konfliktet dhe paqen. Paanshmëria e tij e ka bërë gjykatës të saktë të situatave dhe të zhvillimeve e gjendjeve të ndryshme kombëtare dhe qytetare. Kështu që, ai gjithnjë ka qenë i ftohtë në gjykime, larg simpativë dhe njëanshmërieve. Ai ka vlerësuar se, në jetën kombëtare, intelektuale e qytetare nuk është thjeshtë një person privat, por një institucion, mbarëvajtja e të cilit është shumë më e rëndësishme dhe më e shtrenjtë e më e shenjtë për të, se sa jeta e tij vetjake, të cilën e ka konsideruar gjithnjë kalimtare. Ai i ngjan një busulle që gjithnjë tregon të vërtetën, duke qenë zot i vetvetes dhe zot i institucionit që i ka vënë vetes për detyrë të zhvillojë për interesat e atdheut dhe të kombit të tij, duke fituar kështu autoritetin e një lideri të pagabueshëm.

Përvoja dhe urtësia kanë bërë që Qosja të përsosë portretin e asaj që është e rëndësishme, që është e mirë dhe që është e moralshme, duke dhënë ide për rrugët e zhvillimit dhe largimin nga ajo që është e keqe e që vjen në jetën kombëtare e qytetare me të gjitha pasojat e saj, për të shkatërruar të vlefshmen dhe të nevojshmen e fisniken. Dhe këtë ai e ka arritur duke qëndruar në marrëdhënie të afërta me paraardhësit e mëdhenj, si ato të kombit shqiptar ashtu edhe të kombeve të tjera, çka dëshmon për fuqinë e tij dhe synimin për ta bërë gjithçka sa më mirë e më saktë. Kjo tregon se ai është një njeri fisnik, me shpirt e karakter të fortë dhe me synime të larta, ndaj edhe ka arritur të realizojë një zhvillim harmonik e duke iu afruar përditë përsosmërisë, për të ardhur në atë përfundimin se zhvillimi mendor i kombit është prioritet për mendjet e fuqishme, që kanë aftësinë të krijojnë idetë e të ardhmes.

Qytetar i kombit, por edhe i gjithë botës

Çdo ditë e jetës sate është një faqe e biografisë sate, kujdesu ta shkruash mirë.
Sami Frashëri

Mund të themi pa u lëkundur se Qosja me veprën e tij, i ka bërë një shërbim të madh kombit shqiptar. Ai ka ditur të shpreh ndjenjat kombëtare të shqiptarëve, si dhe të japë modelin e vizionarit për të gjitha kombet drejtë lirisë, duke vënë në pah lavdinë e kombit nëpër breza, përpjekjet, luftërat, zhvillimet, burrat e fortë të kombit dhe të të tjerëve, si dhe vetitë më të mira të popullit tonë, të cilat i ka çmuar gjithnjë, pa i mohuar a fshehur edhe dobësitë e mangësitë. Prandaj mendoj se profesor Qosja është qytetar i kombit por edhe i gjithë botës.

Pra duket se, çka ka të mirë e të lartë natyra njerëzore, si dashurinë për truallin atëror, ndjenjën e lirisë dhe të sigurisë, krijimin e ligjeve mbrojtëse të atdheut, mospranimin e robërisë dhe mospajtimin me pushtimin, luftën kundër pushtuesit dhe bërjen e sakrificave për lirinë, duke mos u shmangur nga vendimi për ta parë kombin të lirë e të bashkuar, janë cilësitë të cilat përbëjnë petkun që mban veshur profesor Qosja. Ndikimi i veprës së Qosjes në jetën kombëtare, në të sotmen dhe të ardhmen e tij, dhe gjerësia e asaj veprë me ndikim dhe në jetën e popujve të tjerë dhe të shoqërisë në tërësi, e bëjnë atë një figurë të përjetshme, duke e larguar nga ata figura që janë të fuqishme vetëm në të gjallë të tyre. Kështu, gjenialiteti i Qosjes qëndron pikërisht në atë, se ka prodhuar vepra jetëgjata, që do të japin ide për zhvillim edhe pas shekujsh historie, pasi duken vepra vitale dhe që i qëndrojnë kohës së të ardhmes.


Përfundim

Njeriu s'mund të gjejë askund një strehë më të qetë dhe më të patrazuar se brenda Shpirtit të tij.
Mark Aureli

Qosja ka ditur të mbështetet në vetvete dhe të jetë në harmoni me veten. Ai e ndërtoj veprën e tij gjithnjë pa u ndikuar nga trysnitë e kohës dhe pa iu nënshtruar asnjë presioni. Pa ndjekur modën, pa bërë punë thjeshtë për të bërë përshtypje e lënë mbresa, pa kërkuar të pëlqehet dhe pa shikuar se çfarë punojnë të tjerët. Ai krijoi gjithnjë atë që ishte e nevojshme, atë për të cilën është i bindur se i nevojitet popullit, atdheut dhe kombit të tij. Asnjëherë nuk e pyeti veten: a kam krijuar diçka që t'ma pëlqejnë, por a kam krijuar diçka që është e duhura për të shërbyer sa më mirë në jetë e qytetarëve të vendit të tij. Kështu, ai gjithnjë ka vlerësuar dhe vlerëson mendimet, dëshirat dhe nevojat e popullit të tij, duke bërë që gjithnjë t'i rritet besimi në vetvete sepse ka punuar për ta pasur shpirtin e tij në harmoni me shpirtin e kombit shqiptar. Vepra e tij është e mbështetur në truallin e kombit, duke ndërthurr brenda saj gjithë mençurinë e paraardhësve dhe të bashkëkohësve, të kompozuar me mjeshtri, që t'i shërbejë kombit drejtë të ardhmes, duke iu nënshtruar vullnetit të fortë, mjeshhtërisë dhe këmbënguljes që tij, për ta përsosur atë vazhdimisht.

(Një vlerësim për Akademikun e madh të shqiptarëve, profesor Rexhep Qosjen, në 70 -vjetorin e krijimit të Institutit Albanologjik dhe në përvjetorin e tij të 87-të të lindjes.)

Prishtinë, më, 21.06.2023



Perëndimi naiv po fle ndërsa fundi i botës po afrohet



Nga Allister HEATH



Ashtu si librat “1984” e George Orwell dhe “Bota e re e guximshme” e Aldous Huxley, del se edhe filmi “Terminator” me protagonist aktorin Arnold Schwarzenegger ishte një plan, dhe jo një vepër fantatiko-shkencore. Kur Skynet, një rrjet kompjuterash i krijuar nga kontraktori ushtarak “Cyberdyne Systems”, u bë i vetëdijshëm, njerëzit në panik u përpoqën ta çaktivizonin atë. Inteligenca artificiale e sapoformuar (AI) i identifikoi “të gjithë njerëzit si një kërcënim” dhe nisi një sulm bërthamor ndaj çdo qyteti të madh. Por 4 dekada më vonë, fikcioni rrezikon të bëhet realitet. Në paralajmërimin më rrëqethës që nga peticioni i Szilárd i vitit 1945, dhe nga themelimi nga Albert Einstein i Komitetit të Emergjencës të Shkencëtarëve Atomikë, shumë nga ekspertët më të mirë në botë, janë të bindur se AI mund të shkatërrojë njerëzimin, dhe se kjo teknologji përbën një kërcënim ekzistencial për mbijetesën tonë si specie. “Zbutja e rrezikut të zhdukjes nga Inteligenca Artificiale, duhet të jetë një prioritet global krahas rreziqeve të tjera në shkallë shoqërore, si pandemitë dhe lufta bërthamore”, - thuhet ndër të tjera në një letër të nënshkruar nga Sam Altman krijuesi i ChatGPT i kompanisë OpenAI, Demis Hassabis i Google DeepMind dhe shumë të tjerë. Ekspertët të tjerë të kësaj fushe, kanë braktisur punën e tyre duke shprehur keqardhje për aq sa kanë bërë deri tani. Frika e tyre është më se e dukshme, ashtu siç është edhe ndjenja se këtë herë kemi shkuar shumë larg, se institucionet tona

nuk mund ta përballojnë dot situatën, se AI do të rrëmbehet nga mendje të liga për të ndërtuar armë të shkatërrimit në masë apo për të sunduar mbi të gjithë ne. Të gjithë mund të gabojnë. Inteligenca Artificiale ka përfitime të mëdha por edhe kosto të konsiderueshme. Atëherë si ka mundësi që kjo çështje nuk është prioriteti numër një i çdo politikani në botë? Si mund t'i besojë dikush se një pakti idiot apo një rregullore formale të BE-së? Ne përballemi aktualisht me një dileme të madhe filozofike dhe praktike: Cili është kuptimi i jetës dhe inteligjencës? Si mund të sigurohemi që njerëzimi të mbetet në krye të makinave dhe jo e kundërta? Si mund të balancojmë synimin e rritjes së produktivitetit me rrezikun e asgjësimit nga këto makineri super-inteligjente? Kjo është padyshim pyetja më komplekse me të cilën jemi përballur ndonjëherë. E megjithatë shoqëria jonë nuk mundet të përballë me të. Sepse elitat globale kanë gabuar sërish me prioritetet që kanë zgjedhur. Ato janë fokusuar në mënyrë obsesive tek ndryshimi i klimës, duke e kthyer një problem real por të kapërcyeshëm në një fe anti-perëndimore, ndërsa janë çuditërisht të pavëmendshme ndaj kërcënimeve shumë më të mëdha. Unë nuk po e minimizoj aspak problemin dhe kostot e ndryshimit të klimës. Por e di se ato nuk do t'i japin fund jetës në Tokë, ndryshe nga një luftë bërthamore, luftë biologjike apo një Inteligjencë Artificiale e dalë jashtë kontrollit. Nxitimi ynë drejt arritjes së zeros emetimeve të gazrave ndotës në atmosferë, duke e reduktuar rritjen ekonomike, po e kufizon në fakt aftësinë tonë për të zhvilluar një

përballje me një Kinë që po vazhdon me emetimet e saj të shumta të dioksidit të karbonit. Rreziku më i menjëhershëm për mbijetesën e njerëzimit është lufta bërthamore. Rusia mund të lëshojë ende armë bërthamore taktike ndaj Ukrainës; Kina mund të pushtojë Tajvanin; ose një sulm terrorist mund të zhysë Indinë dhe Pakistanin në një luftë totale midis tyre. Megjithatë, rreziku më urgent vjen nga përhapja armëve bërthamore, një krizë që përhapet dalëngadalë dhe që bie ndesh me narrativat aktuale, dhe që për pasojë anashkalohet. Koreja e Veriut mbetet një kërcënim i madh, por rreziku i vërtetë është Irani: ai vazhdon të pasurojë uraniumin dhe dëshiron të asgjësojë Izraelin. Rreziku tjetër i madh është lufta biologjike. Mendoj se është çmenduri që ne vazhdojmë të tolerojmë eksperimentet me viruset dhe modifikimin e tyre gjenetik: një moment, një virus super i fuqishëm mund të dalë aksidentalisht ose qëllimisht nga një laborator, duke vrarë miliarda njerëz dhe duke e shkatërruar qytetërimin tonë. Dhe ku është në këtë rast zemërimi dhe parada e aktivistëve të shqetësuar? Inteligenca Artificiale e dalë jashtë kontrollit, mund të favorizohet nga një patologji në rritje në zemër të shoqërisë perëndimore: varësinë tonë ndaj kolektivit. Në vend se të krijojmë një ushtri individualistësh racionalë dhe elastikë, të pavarur, hiper-edukuar dhe me të gjithë mësimin njerëzor në majë të gishtave, telefonat inteligjentë na kanë reduktuar në një turmë shumë emocionale, shtazarake, dhe të drejtuar nga dopamina. Sot ka shumë informacione, por

pak njohuri. Në vend se të jemi në gjendje të mendojmë vetë, ne jemi skllëvër të modës, jo vetëm kur flitet për veshjen, por edhe për opinionet, konsumin dhe vendimet financiare. Të radikalizuar nga mediat sociale, formuesit e elitës së opinionit, përqafojnë pikëpamjet absurde, dhe e bëjnë këtë me një shpejtësi marramendëse. Politikanët, bizneset dhe personazhet e famshëm, marrin shkas nga një pararojë revolucionare që po përmbys ndjenjën e përgjegjësisë publike. Shoqëria jonë nuk e kupton më qëllimin e fjalës së lirë, siç e përshkruan John Stuart Mill në esenë e tij “Mbi lirinë”. Në vend se të angazhohemi në një katekizëm sokratik për të arritur tek e vërteta, ne përdorim fjalë për të sinjalizuar virtytin dhe për të fshehur emocionet bazë. Elitat tona pretendojnë se janë humanistë universalistë. Në fakt ato janë tribalistë të rilindur, të cilët e kalojnë kohën e tyre duke u vendosur përballë grupeve të jashtme (cilido që nuk është dakord me ta). Ne nuk po dimë të mendojmë më në një mënyrë kritike. Subjektiviteti dhe nihilizmi sundojnë në mënyrë absolute: kulti i çmendur dhe post-modernist i lëvizjes “Woke”, pretendon se nuk ka më të vërteta universale, por vetëm të vërtetat tona. Idetë janë në rastin më të mirë të mira pozicionale, pra deklarata që janë në modë, shënjuese të hierarkisë sociale, dhe në rastin më të keq mjete shtypjeje. Fjalët nuk kanë më asnjë kuptim thelbësor: shprehja e “mendimit të drejtë” sinjalizon një status të lartë (edhe nëse opinionit është i pakuptimtë, siç është pretendimi se Kina nuk

kishte asnjë lidhje me Covid-in) dhe “të menduarit e gabuar” (siç është mbështetja për Brexit) nënkupton një status të ulët. Alex Tabarrok i George Mason University, argumenton se shoqëria jonë nuk është thjesht gjithnjë e më kapriçioze, por edhe e prirur ndaj një çmendurie të re të turmave. Duke e rritur transparencën dhe duke ulur kostot e transaksionit, teknologjia ka “intensifikuar çmendurinë e masave dhe ka zgjeruar shtrirjen e tyre, nga financat te politika dhe kultura, asnjë fushë nuk mbetet e paprekur”. Paniku bankar është gjithnjë e më i shpejtë, ku depozitat zhvendosen nga llogaritë online sapo fillojnë të qarkullojnë disa zëra alarmantë. Lajmet e rreme, bojkotet, zemërimi, demonstratat, paniku shëndetësor dhe thirrjet për falimentim të bankave po bëhen një normë. Nuk ka asnjë mekanizëm për korrigjimin e gabimeve. Një botë e tillë – e qeverisur nga parimet e kundërta me ato të zhvilluara nga Nassim Nicholas Taleb në librin “Antifragile” – është e ndjeshme ndaj manipulimit, dhe rrjedhimisht ndaj përdorimit si një armë e Inteligjencës Artificiale. Imagjinoni një video të falsifikuar në mënyrë të rafinuar (deepfake) të parë 20 milionë herë brenda pak orësh, që paralajmëron për një sulm të afërt terrorist, apo që “provon” se një politikan ishte një mashtrues disa orë përpara zgjedhjeve: ndikimi do të ishte katastrofik. “A mund t'i mbijetojmë teknologjisë?” - pyeti në vitin 1955 John von Neumann, mendja më e madhe e shekullit XX-të. A mund të jetë vërtet negative përgjigja? / Daily Telegraph – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Fanella e Kosovës, është fanellë... e gjakut



Shkruan: Driton LATIFI

S'di kah me ia nis, as s'di çka t'ju them... veç një gjë e kam gjithë kohën në krye: Kosova nuk e meriton paraqitjen, angazhimin e lojën që jeni duke e treguar! Mendova mos të shkruaj, por diçka si shumë prej njerëzve që e duan këtë vend, po më ha diçka brenda thellë në vete, diçka po më gërryen dhe keq... Në këtë situatë fajtor nuk është vetëm trajneri, jeni edhe ju lojtarët! Humbja është pjesë e lojës dhe nuk mund të jeni imunë as ju dhe askush tjetër nga ajo, por mungesa e angazhimit, përkushtimit, bashkëpunimit janë të pafalshme. Dhe kështu do të jetë gjithmonë. Pas gjithë atij glorifikimi që jua kemi bërë, na dëshpëruat, na zhgënjyjet edhe atëherë kur kishim nevojë për fitore si komb. E dimë se ju nuk i zgjidhni hallet e këtij vendi, as problemin e veriut, as problemet sociale e shumëçka tjetër, por ju jeni populli, ju jeni ne! Ajo fanellë që e vishni në çdo penj të saj ka erë gjaku, erë nga një copë rrobash të bëra me gjak nga të burgosurit, dëshmorët, familja Jashari e deri te

fëmija e nëna e Abrisë. Aty ka penj të atyre që kanë dhënë më të mirët për këtë vend, janë edhe penjtë e prindërve tuaj nga rrobat që kanë ikur nëpër male për një jetë tuaj më të mirë. Është një fanellë e larë me gjak dhe ai gjak është krenari në sytë tanë sa herë që e vishni e fluturoni me të. Është fanellë e re, për botën, por me peshë shumë të madhe për ne. Është fanellë që nëse nuk e ndieni, aman mos e vishni, na bëni nder mos me veshë, se nuk është fanellë mode e trendësh, por dinjiteti e ideali. Është fanellë që e kanë ëndërruar prindërit tuaj, gjyshërit, familjet, iks talente, por hej vetëm juve po ju jepet mundësia, aman ruajeni si sytë e ballit. Është fanellë ndryshe nga ajo e klubit. Kjo nuk ju jep shkëlqimin e përditshëm, por të përrjetshëm. Është fanellë që ju ka bërë të arrini aty ku jeni në klube dhe asaj mbrapa po i jepni shumë pak kohët e fundit. Është fanellë që nuk kërkon motiv shtesë. Është fanellë e popullit e secilit në Kosovë e sidomos bashkatdhetarëve tanë, prandaj të gjithë kemi të drejtën e pamohueshme me kërkua përgjegjësi. Është një fanellë që

shumëkënd e bën të mendojë se edhe me vdekë, të mos i mbetet asnjë peng në këtë jetë. Dhe këtu kujtoj gjithë ato gjenerata lojtarësh që në vitet e mbijetesës vendosen themelet e shtetit tonë. Kushtet i keni maksimale, hotele pesë yjesh, aeroplanë charter që përdor edhe Manchester Unitedi, logjistikë e kujdes maksimal nga Federata më e re në Evropë. Madje edhe motivi financiar nuk mungon, shpërblime apo premia për barazim e fitore, ndërsa shifra milionëshe për kualifikim... dhe duket se as këto nuk ju mjaftojnë! Mbytja e atmosferës brenda, krenaria e tepruar e mosrespektimi i kundërshtarit ju ka kushtuar dhe do t'ju kushtojë gjithmonë.

Na duhet një trajner i ri. Po, na duhet. Trajnerët shkojnë e vijnë, por doktrina e ekipit duhet t'i ketë tri elemente: krenari, luftë dhe respekt. Janë disa lojtarë që e ndiejnë veten senatorë, pas disa ndeshjeve, por harrojnë se ka shumë më tepër njerëz që kanë dhënë për atë fanellë, që nuk kanë marrë asgjë mbrapa dhe këta i takoj çdo ditë. Mos harroni, Kosova është mbi të gjitha!

SHKURT

Nëntë Kombëtare në Evropianin në Prishtinë

Nëntë ekipe kombëtare do të paraqiten në Kampionatin Evropian që prej 8 deri më 16 shtator mbahet në kryeqendrën e Kosovës. Evropiani i Hendbollit është për Kombëtares U19 në konkurrencën e femrave. Disa prej kombëtareve janë të vendeve që kanë sport e hendboll shumë të zhvilluar. Rrjedhimisht Prishtina prej 8 deri më 16 korrik do të jetë qendër e rëndësishme e hendbollit kontinental. Në Evropianin e Divizionit B, pos Kosovës, marrin pjesë edhe Austria, Britania e Madhe, Italia, Letonia, Sllovakia, Finlanda, Izraeli e Polonia. Spektakli i hendbollit do të madhësohet me praninë e shikuesve në tribuna.

Luiza Gega, kampione me rekord në Evropianin Ekipor

Luiza Gega ka arritur ta fitojë garën e 3 000 metrave me pengesa në Kampionatin Ekipor Evropian të Atletikës që po zhvillohet në Krakow të Polonisë. Gega fitoi në divizionin e tretë të garës, duke regjistruar kohën 9:17.31. Një sukses historik për Gegën, e cila arrin fitoren e 11-të në historinë e kampionateve të ndryshme evropiane, duke barazuar me kampionen bullgare Ivet Lalova-Collio. Kampionia shqiptare, gjithashtu, ka vendosur edhe rekord për femrat me kohën e saj. Vetëm pak ditë më parë Gega arriti të shpallej fituese edhe në garën ekipore të 5 000 metrave në Kampionatin Evropian në Poloni.

Drenica Futsal 'blindon' Mentor Mejzinin

Drenica Futsal ka njoftuar se ka arritur marrëveshje të re me lojtarin e njohur Mentor Mejzini, i cili ka vendosur të dërrasë fanellën kuqezi edhe në të ardhmen. "Pas kontributit të tij të jashtëzakonshëm në kampionatin që lamë pas, është një gjë e shënuar që ai ka vendosur të vazhdojë bashkëpunimin me Drenicën. 'Lata', përveç cilësive si lojtar, ai shquhet edhe për etikën e punës së tij, profesionalizmin dhe përkushtimin ndaj ekipit. Me vendosmërinë e tij për t'i përmbushur objektivat e klubit, besojmë se Mentor Mejzini do të vazhdojë të na frymëzojë dhe të na ndihmojë t'i arrijmë objektivat e klubit", thuhet në njoftimin e Klubit të Drenicës në Futsall.

Muhamet Ramadani renditet i treti në Lojërat Evropiane

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Atleti i Kosovës, Muhamet Ramadani, ka zënë vendin e tretë në Lojërat Evropiane "Krakow 2023", të cilat për atletikën vlejnë si Kampionat Evropian ekipor, divizioni i tretë. Garuesit nga Kosova i kanë nisur mirë garat në Lojërat Evropiane që po mbahen në Poloni. Është mitrovicasi Muhamet Ramadani i cili ka zënë vendin e tretë në hedhjen e gjyles.

Ramadani hodhi gjylen në distancë prej 19.07 metrash, duke përfunduar i treti nga 14 garues sa morën pjesë. Ky është njëherësh suksesi më i madh i atletikës në Lojërat Evropiane të vitit 2023. Rezultati i Ramadanit tregon se ai vazhdon ngritjen dhe paraqitjen e sotme do të jetë motiv shtesë para Kampionatit Evropian U-23 që mbahet muajin e ardhshëm. Ndërsa

Nexhat Sahiti ka përfunduar garimin në garat e shenjëtari sportive. Me 568 pikë, shenjëtari i Kosovës doli i 31-ti, në disiplinën 10 metra pistoletë ajrore, duke mos arritur të kualifikohet në finale. Sahiti kishte disa momente të mira, sidomos në serinë e katërt, ku qëlloi 9 dhjetëshe nga 10 sosh, por që nuk pati ecuri të tillë edhe në seritë e tjera.



Sylvinho shkruan shqip: Rezultatet, falë punës në grup. Forca Shqipëri!

TRANË, 22 QERSHOR - Shqipëria arriti të marrë gjashtë pikë në dy ndeshjet e fundit në kualifikueset për Evropianin e Gjermanisë. Së fundmi trajneri i kombëtares kuqezi, Sylvinho, ka bërë një postim në "Instagram", duke i dedikuar

një status kombëtares. Tekniku brazilian e ka shkruar këtë mesazh në portugalisht dhe në shqip. "Këto kanë qenë ditë intensive dhe shumë produktive pune e përgatitjeje për dy ndeshjet. Ky grumbullim na ndihmoi për ta njohur

grupin e lojtarëve më në detaje dhe ta ushqenim akoma më shumë lidhjen tonë të mrekullueshme. Rezultati ishte dy fitore, me numra të rëndësishëm. Unë jam i bindur se e gjitha kjo ishte rezultat i punës në grup: lojtarë, staf

teknik, punonjës dhe drejtues të Federatës Shqiptare të Futbollit si dhe fansat, të cilët na inkurajuan shumë në fushën tonë dhe na dhanë një energji të mirë për ndeshjen e dytë. Ecim përpara. Forca Shqipëri!", ka shkruar strategu brazilian.



Muriqi udhëheq sulmin në formacionin e sezonit të Ligës së Kombeve

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Faqja e njohur e statistikave "Sofascore" ka publikuar formacionin më të mirë të sezonit 2022/24 në Ligën e Kombeve, e cila u mbyll para disa ditësh. Sezioni i Ligës së Kombeve përfundoi më 18 qershor, ku Spanja triumfoi ndaj Kroacisë falë fitores në penallti me rezultat 5-4. Megjithatë, pjesë e formacionit më të mirë të të gjithë sezonit në Ligën e Kombeve gjendet vetëm një spanjoll dhe asnjë kroat. Portieri Unai Simon është i vetmi pjesë e formacionit me një notë mesatare prej 7.22. Por, ajo që bie në sy është prania e sulmuesit të Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqit, i vetëm në majën e sulmit të formacionit më të mirë nga "Sofascore". Muriqi është i dyti me notën më të lartë në formacionin, duke pasur mesatare prej 7.90, ndërsa para tij ishte vetëm Kvícha Kvaratskhelia me notë mesatare prej 7.95. Si sulmuesi i Kosovës,



ashtu edhe ylli gjeorgjian patën nga 5 gola dhe 3 asistime, duke qenë më produktivët gjatë këtij edicioni të Ligës së Kombeve. Pjesë e formacionit ishin edhe emra si Kostas Mavropanos, Nathan Collins, Igor Armas, Joshua Kimmich, Pierre Hojbjerg, Roberts

Savaliëks, Anastasios Bakasetas dhe John McGinn. Ndryshe, Kosova në sezonin e fundit ishte pjesë e Grupit 2 të Ligës C, ku përfundoi e dyta me 9 pikë, gjashtë më pak se Greqia e para dhe katër më shumë se Irlanda e Veriut e treta dhe Qipro e katërta.

Barça synon të shesë pesë lojtarë para korrikut

BARCELONË, 22 QERSHOR - Kampionia e LA Ligës, Barcelona, duhet ta lirojë faturën e pagave nëse dëshiron të bëjë nënshkrime këtë verë. Klubi, sipas "Sport", tashmë ia ka nisur punën për ta përshtetur procesin. Plani është të shiten lojtarët në të cilët Xavi nuk llogarit, nëse është e mundur para 30 qershorit. "Fair-Play"-i financiar po i shkakton dhimbje koke Barcelonës. Derisa "Cules" të jetë në gjendje t'i çlirojë pagat, klubi nuk mund të nënshkruajë me lojtarë. Me këtë pasiguri, disa nga lojtarët që presin një telefonatë nga gjigantët katalanas kanë zgjedhur opsione të tjera. Messi e ka humbur tashmë një lëvizje të Barçës për këtë arsye dhe klubi nuk dëshiron që kjo të përsëritet me asnjë lojtar tjetër. Barça nuk ka mbetur pa zgjidhje tjetër veçse ta trajtojë fillimisht "operacionin e largimeve". Klubi e di se është në nxitim për t'i hequr qafe lojtarët nëse duan të sjellin përfundime këtë verë. "Sport" raporton se skuadra e



"Camp Nou" tashmë është duke punuar për disa largime. Ka lojtarë që kanë përfunduar huazimet e tyre përkatëse dhe që nuk llogariten për Xavin, ndaj kërkohet një rrugëdalje. Gazeta katalanase përmend Lenglet, Umtiti, Dest, Collado dhe Gustavo Maia. Nëse ata arrijnë t'i largojnë këta pesë lojtarë, klubi do të kursente 50 milionë euro në paga, gjë që do t'u jepte atyre pak hapësirë

për manovrim. Në parim ai që do ta kishte më të lehtë të largohej do të ishte Lenglet. Lojtari kohët e fundit u kthye nga huazimi i tij në Tottenham, por "Spurs" ishte i kënaqur me të dhe mund t'i fillonte menjëherë negociatat për nënshkrimin e tij. Barça mund të marrë 10 milionë për shitjen e tij, përveç tarifës prej 16 milionë eurosh.

SHKURT

PSG-ja kërkon 200 milionë për Mbappen

Kylian Mbappe mbetet një temë e nxehtë e kësaj merkatoje vere. Ylli francez deklaroi publikisht se nuk do ta rinovojë kontratën aktuale me PSG-në që i përfundon më 2024. Kaq mjaftoi që në lëvizje të vihej Real Madridi, klub që e ndjek prej kohësh. Sipas "El Chiringuito TV", as PSG-ja nuk ka qëndruar në heshtje, por i ka vendosur një çmim: çdo skuadër që kërkon shërbimet e Mbappes duhet të paguajë 200 milionë euro. Kërkesa e PSG-së është shumë larg asaj që Real Madridi ka ofruar, 120 milionë euro. Reali është në një pozicion komod pasi, nëse PSG-ja nuk pranon ofertën e tij, mund ta marrë falas më 2024.

Dzeko nga Interi transferohet te Fenerbahçe

Sulmuesi Edin Dzeko tashmë është transferuar nga Interi te Fenerbahçe në Turqi me parametra zero. Kontrata e sulmuesit veteran boshnjak me zikaltrit ka skaduar dhe palët nuk negociuan për ta rinovuar, kështu për Dzeko kishte interesim të lartë klubi Fenerbahçe dhe tashmë e zyrtarizon këtë. Aktualisht Dzeko ndodhet në Stamboll për t'i kaluar vizitat mjekësore dhe për ta hedhur firmën. Më pas, boshnjaku do të paraqitet përpara shtypit. 37-vjeçari ka luajtur 101 ndeshje në total me Interin, ku ka shënuar 31 gola dhe ka asistuar 15 herë.

UEFA suspendon Mourinhon me katër ndeshje

Jose Mourinho është dënua nga UEFA për finalen e Ligës së Evropës në mes të Romës dhe Sevilas. Sipas njoftimit të UEFA-s, Jose Mourinho është suspenduar me katër ndeshje të UEFA-s pas fjalorit abuziv ndaj gjyqtarit të asaj ndeshjeje. Trajneri portugez kishte kaluar në procedurë disiplinore pas asaj ndeshjeje, ndërsa sot i erdhi edhe vendimi. Roma e humbi atë finale me penallti ndaj Sevilas.

Lewandowski: Do ta mbyll karrierën në Barcelonë

Sulmuesi Robert Lewandowski, pas mbylljes së këtij sezoni (2022-2023), ka folur për të ardhmen e tij në një intervistë për "Canal Plus". 34-vjeçari është i vetëdijshëm se është në vitet e fundit të karrierës së tij. "Momenti i tërheqjes time nga sporti po afrohet dhe me shumë gjasë, lamtumira do të vijë me fanellën e Barcelonës. Unë dhe familja ime ndihemi vërtet komodë këtu ku jemi", u shpreh Lewandowski, që mbylli sezonin e parë me fanellën e ekipit "blaugrana". Këtë sezon sulmuesi polak realizoi 33 gola në 46 ndeshje në total me Barcelonën (23 gola në kampionat). "Vetëm pasi ta mbyll kontratën aktuale me Barcelonën do të vendos nëse do të luaj ende apo jo. Për momentin dua ta respektoj kontratën aktuale që kam këtu", ka shtuar sulmuesi polak.

Di Maria refuzon Inter Miamin për Benficën

Anësori Angel Di Maria do të refuzojë një ribashkim me Lionel Messin në Inter Miami dhe të nënshkruajë për ish-klubin Benfica këtë verë. Inter Miami ishte shpallur destinacion i

mundshëm për Di Maria pasi kontrata e tij me Juventusin skadon, pasi skuadra e Major League Soccer tashmë e ka joshur Messin, bashkëlojtarin e tij ndërkombëtar, me të cilin

fitoi Kupën e Botës në Katar. Megjithatë, Fabrizio Romano tani raporton se 35-vjeçari do të ribashkohet me skuadrën portugeze, për të cilën ai luajti midis viteve 2007 dhe 2010, përpara se të

bashkohej me Real Madridin. Di Maria ka vendosur kundër vazhdimit të marrëveshjes së tij me Juven dhe kështu është në dispozicion si një transferim i lirë. Ai është një

ikonë e Benficas, pasi ka fituar titullin e ligës me klubin në 2009-10, fitorja e parë e titullit në katër sezone, dhe tani është i vendosur për një rikthim heroik.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

